

ABDUL MECHID EZ-ZINDANI



VĚRTETĚSIA
E
JETĚS

Abdul Mexhid Ez-Zindani

Vërtetësia e Jetës

Tiranë 2005

-Vërtetësia e Jetës-

Përshtati në shqip: Altin Abdullah Torba

<http://www.jetaever8.de/>

Kopertina:
Eduart Thartori

Botues:
Alfred Ziu

Tiranë. 2005

Pasqyra e lëndës:

Cili është qëllimi i vërtetë për të cilin u krijua njeriu?

Cili është qëllimi i vërtetë i jetës së kësaj bote?

Vërtetësia e ekzistencës së njeriut?

1. Kjo jetë është një fazë, etapë apo seri e serialit “ekzistencë njerëzore”f -11-
2. Bindja e krijuar ndër disa njerëz se njeriu është krijuar kot.....f -23-
3. A është qëllimi i ekzistencës njerëzore i njëjtë për të gjithë njerëzit?.....f -29-
4. Qëllimi i krijimit të njeriut e kapërcen këtë botë.....f -34-
5. Kjo botë është bota ku provohemi për sa na është lënë në përgjegjësi.....f -42-
6. Çfarë nënkupton thënia se kjo dynja është bota e sprovës.....f -53-
7. Jeta e kësaj bote është përsosur e atillë që në të të realizohet provimi i njeriut....f -61-
8. Si mund të dalë i suksesshëm njeriu në provimin jetë?.....f -72-
9. Koncepti islam se toka ku ne jetojmë s’është veçse arena e sprovës.....f -76-
10. Cili është realiteti i kësaj bote, vërtetësia e kësaj jete.....f -82-
11. Përse kjo botë e rrejshme na josh pa masë dhe na duket si e përjetëshme?.....f -90-
12. Qëllimi i krijimit të njeriut.....f -93-
13. Jeta e mosbesimtarëve.....f -95-

Hyrje:

“Kur një pikëlz uji e kulluar avullon nga oqeani, pikëlzat e tjera të oqeanit mendojnë se për të ky është fundi, porse në të vërtetë ajo gjendet lartë në qiell... E pikëlzat e tjera të oqeanit nuk mundën ta mësojnë këtë të vërtetë, vetëm se pasi t’i nënshtrohen të njëjtit udhëtim që kjo pikëlz ka përshkuar.”

Shkëputur nga filmi “Oktapodi”

Njeriu i mençur vëren qartazi sesi gazetaria dhe media “goja dhe syri i botës” që posedohen nga njerëz me zemra dhe interesa të ngushta, nuk bëjnë gjë tjetër veçse vjellin parreshtur mosbesimin, shthurjen dhe frikën.

Vjellin mosbesimin nën moton “shijo momentin” dhe “shfrytëzoje këtë botë” me çdo lloj mënyre e mos çaj kokë për ekzistencën e botës së përtejme të përgjegjësisimit, gjykimit dhe shpërblimit.

Vjellin shthurjen, lakuriqësinë dhe degjenerimin nën moton “femra moderne dhe arti”, kësaj shthurjeje totale apo të pjesëshme që dikush ndoshta me të drejtë e ka quajtur “tregëtia e mishit të bardhë”; vjellin shthurjen, lakuriqësinë dhe degjenerimin nën moton “modernizim dhe qytetërim” ku në fakt sundon mafia, narkotizmi, shthurja dhe shfrenimi me të gjitha trajtat e tyre.

Vjellin frikën nga mafia, krimi, kërcënimi dhe pasiguria që në të shumtën e rasteve; si në servirjet kinematografike ashtu edhe në ato të jetës së përditëshme; vishen me rrobën e organeve më të larta të drejtësisë, policisë dhe hetuesisë.

Pikërisht në brendi të kësaj piramide të errët trekëndore “mosbesim-shthurje-frikë” me bazë ateizmin është robëruar pa vetëdije çdo njeri që nuk

beson. Sepse nuk i ngelet tjetër njeriut përveçse të besojë ose të bjerë viktimë e humbjes, kotësisë, shthurjes dhe frikës që propagandohen 24 orë -non stop- në skenarin e realitetit të errët të shoqërisë ateiste bashkëkohore dhe në skenarin dashakeq dhe të kurdisur të medias elektronike dhe asaj të shkruar...

- O njerëz të mençur! A mos prisni nga kjo errësi të t'ju udhëzojë për tek drita...

A nuk më jepni të drejtë që të pyes se edhe për sa kohë do të vazhdojë të ngelet njeriu injoranti më i madh në lidhje me vetveten e tij...?!

Të ngelet injorant edhe pse mund të jetë nga kokat më të mençura të filozofisë dhe mendimit...

Filozofi dhe mendimtari me famë botërore Alekses Karel, edhe pse nga krerët e padiskutueshëm të filozofisë botërore, nëpërmjet titullit të librit të tij të famshëm "Njeriu. Ky mister i madh", shpreh qartazi hezitimin e tij në lidhje me pse-në e ekzistencës së njeriut.

Kurse poeti ateist nxjerr në pah hezitimin e tij në lidhje me pse-në e ekzistencës së tij nëpërmjet vjershës së tij të shumënjohur ku thotë:

"Erdha... Nuk e di se nga, porse di që erdha.
Pashë para meje rrugë dhe mbi të unë eca.
E do të ngelem duke ecur desha apo nuk desha.
Nga erdha? Nuk e di.
Pse erdha? Nuk e di.
Përse nuk e di? Nuk e di..."

- Edhe për sa kohë do të vazhdojë të ngelet njeriu injoranti më i madh në lidhje me vetveten e tij...?!

"Qytetërimi" modern i ka mësuar njeriut si të hajë bukur, si të flasë bukur, si të vishet bukur, si të sillet bukur..., porse nuk ka arritur t'i mësojë njeriut gjënë më kryesore, se përse njeriu i bën gjithë këto gjëra, përse jeton...

-Abdul Mexhid Ez-Zindani-

- Edhe për sa kohë do të vazhdojë të ngelet njeriu injoranti më i madh në lidhje me vetveten e tij...?!

A nuk e di njeriu se ajo që shkatërron çdo kënaqësi, ëndërr dhe ambicie, vdekja, mund ta befasojë atë nga njëri çast në tjetrin?!

- Edhe për sa kohë do të vazhdoshë të ngelesh o njeri injoranti më i madh në lidhje me vetveten tënde...?!

Çfarë pret o njeri?!

A mos pret ndonjë tërmet si ai i Lisbonës në Portugali që në pak çaste u mori jetën mbi shtatëdhjetë mijë vetëve? Apo si ai i Kinës që në pak minuta u mori jetën mbi tre milion vetëve? Apo pret ndonjë aksident që mund të të befasojë në çdo moment? Apo pret infarktin të të marrë në krahët e tij të zi e të të nxjerrë nga kjo jetë edhe pse pa shkak të prekshëm shëndetësor? Apo...? Hë pra, a pret vdekjen të të nxjerrë nga kjo botë e ta leshë atë si të mos kesh ekzistuar kurrë më parë?

- Edhe për sa kohë do të vazhdojë të ngelet njeriu injoranti më i madh në lidhje me vetveten e tij...?!

Ja! Sot mbi shtyllat e qytetit janë afishuar ca njoftime...

Dikush afrohet t'i lexojë...

Po, po! Këto njoftime bëjnë fjalë pikërisht për ty, bëjnë fjalë për vdekjen tënde...

Dikur vetëm kishe dëgjuar për të vdekurit, kurse sot je një prej tyre...

Dikur vetëm i kishe vizituar e soditur varrezat, kurse sot je një prej banorëve të tyre...

Dikur përpiqeshe në hallall ose haram që ta ushqeje trupin tënd, kurse sot trupi yt është bërë ushqim për krimbat e tokës...

-Vërtetësia e Jetës-

Dikur ecje mbi tokë me krenari dhe mburrje, kurse sot gjendesh i tëri brenda barkut të tokës...

Ja! Tashmë në mizërinë e varrezave edhe një varr i ri... Ndër banorët e varrezave edhe një banor i ri...

Dikush afrohet të lexojë emrin mbi pllakadën e ftohtë të këtij varri... Lexon mbi të emrin tënd... Datën e befasishme të vdekjes tënde që të mori dhe të nxorri nga kjo botë pa të kërkuar leje aspak...

Dikush teksa ecën i strukur nën rrobën e tij të ngrohtë i hedh sytë e tij rrëmbimthi nga varrezat dhe i mëshiron këta banorë të varreve të ngushta që dikur ndoshta jetuan në vilat dhe çifligjet e gjëra... dhe harron ky i gjorë se një ditë edhe ai do të rradhitet në rradhët e tyre.

- Edhe për sa kohë do të vazhdoshë të ngelesh o njeri injoranti më i madh në lidhje me vetveten tënde...?!

A nuk e dëgjove vjershëtorin që nëpërmjet vargjeve të tij të qëllimta u përcjell mesazhin e tij njerëzve të mençur:

“Një ditë unë vizitova varrezat dhe mbi pllakadat e ftohta shumë data unë pashë. Ja! Mbi këtë varr të vogël lexoj një mbishkrim që tregon se banor i këtij varri të vogël, është një foshnje që vdiq pa dalë ende nga barku i nënës.

Kurse këtu më tej, mbi këtë pllakadë varri është vizatuar një trëndafil i këputur dhe poshtë tij është shkruar: “Kujtim nga familja”, një mbishkrim, familja që shumë e donte djalin e saj ka lënë për të, thjeshtë këtë kujtim.

Ec edhe më tej. Një plak ka vdekur, grua, burrë apo fëmijë.

-Abdul Mexhid Ez-Zindani-

Ja edhe varri i një djali të ri!
Dikur e kam njohur këtë njeri.
Mbi pllakadën e varrit ish e fejuara e tij
-që tashmë është martuar- pati lënë një
mbishkrim,
e tashmë për të, ish i fejuari i saj, s'ka ngelur
veçse një vegim,
një vegim mendimesh që rrallë herë shkrepëtin...
E pas vdekjes ai që të deshi më së tepërmi
a e di se kush është nderimi më i madh që do të
bëjë?
Ca lopata dhë më tepër, konkurs kush e kush më
parë të të mbulojë...
Banorë të varreve të ngushta
që dikur jetuan në këtë botë të gjerë,
lindën, jetuan, dhe vdekja i transferoi
në Botën Tjetër, në përjetësi, në amshim
atje ku i pret shpërblim ose ndëshkim.
Sa keq që shumë prej këtyre njerëzve lindën,
jetuan, dhe dolën nga kjo jetë e shkretë,
pa ditur për ekzistencën e tyre asnjë qëllim..."

- Edhe për sa kohë do të vazhdosh të ngelesh o
njeri injoranti më i madh në lidhje me vetveten
tënde...?!

- Për këtë shkak zgjodhëm këtë material të
zgjedhur që lusim Zotin të shërbejë si një derë e vogël
hyrje për në kaltërsitë dhe horizontet e përjetëshme të
besimit.

(Altin Abdullah Torba)

<http://www.jetaever8.de/>

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit.

Cili është qëllimi i vërtetë për të cilin u krijua njeriu?
Cili është qëllimi i vërtetë i jetës së kësaj bote?
Vërtetësia e ekzistencës së njeriut?

1 - Kjo jetë është një fazë, etapë apo seri e serialit “ekzistencë njerëzore”.

Thënia Kuranore thotë:

“Vërtetë që e krijuam njeriun nga një ajkë prej balte¹ (-fazë-). Më pas, e bëmë atë pikë uji (bëhet fjalë për qelizën e parë njerëzore, zigotën) në një vend të sigurt (-tjetër fazë-). Më pas atë pikë uji e bëmë copë gjaku të ngjizur (-fazë-); e atë copë gjaku të ngjizur e shndërruam në copëz mishi (-fazë-); pastaj atë copëz mishi e shndërruam në eshtra (-fazë-); dhe eshtrat i veshëm me mish (-fazë-); pastaj e bëmë atë një krijesë tjetër (me ndjenja dhe shpirt,-fazë-). I Lartësuar është Allahu më i miri Krijues! Më pas, ju do të vdisni (-fazë-). Pastaj ditën e kijametit do të ringjalleni (-faza e fundit- nëpër të cilën kalon qenia njerëzore sipas Kuranit Fisnik, fjalës së Allahut të Lartësuar, Krijuesit të njeriut).” El-Muminun (12-16)

¹ Është vërtetuar shkencërisht se trupi i njeriut përmban në brendinë e tij komponentët bazë të lëndës së tokës. Në thënien Kuranore në fjalë flitet për krijimin e materies së trupit të njeriut të parë, Ademit, direkt nga ajka e baltës së tokës, nëpërmjet një procesi të mahnitshëm transformimi. E transformimi i mëpasshëm =

-Vërtetësia e Jetës-

Duke qenë se kjo botë s'është veçse një fazë prej fazave nëpër të cilat kalon ekzistenca e qenies njerëzore, cilido që do të dijë domethënien apo vërtetësinë e ekzistencës së qenies njerëzore në këtë jetë duke u kufizuar vetëm në këtë botë, nuk do të mund të arrijë kurrë në një rezultat të saktë.

Kështu, nëse ti do të dish se përse ekziston apo thënë ndryshe se çfarë qëllimi ka ekzistenca e spermatozeidit dhe vetëm kaq e asgjë më tepër -nuk njih veçse një lëng spermatozeik që përmban në vetvete spermatozeid mikroskopik-, sado që të filozofosh dhe sado që të mendosh, po që se nuk i marrë në konsideratë fazat e mëpasshme; pllenimin e spermatozeidit të mashkullit me vezoren e femrës -si pasojë e të cilit bëhet i mundur krijimi i qelizës së parë njerëzore-, pastaj shndërrimin e qelizës mëmë në masiv gjaku të ngjizur, pastaj në copëz mishi të kafshuar, pastaj në eshtra të cilat më pas mvishen me një shtresë prej inde muskujsh dhe mishi, pastaj formësimin përfundimtar dhe transformimin e plotë të embrionit njerëzor në trajtën e krijesës njerëzore dhe së fundi fazën

= i materies së trupave të qenieve njerëzore në mënyrë indirekte nga lënda e tokës, nuk qëndron prapa në mënyrën e mahnitëshme sesi Krijuesi i Plotfuqishëm e përsosi një gjë të tillë. Ishte kjo lëndë e tokës ajo e cila në sajë të ligjësive të mahnitëshme të përsosura prej Krijuesit, u transformua në bimë; pastaj në fruta bimësh, në trupa kafshësh dhe nga ky ushqim bimor dhe shtazor ne njerëzit përfituam proteinat, kripërat minerale, niseshtenë, lypërat etj; që më pas u transformuan në qeliza njerëzore dhe së fundi në mish, kocka, flokë dhe në të gjithë përbërësit e tjerë të trupit njerëzor. Lënda e tokës është faktori i patjetërsueshëm tek i cili Krijuesi ka bërë që të mvaret totalisht mbarëvajtja dhe ecuria në vazhdim e jetës biologjike të qenieve njerëzore dhe mbarë botës shtazore. E pra shndërrimi i mahnitshëm direkt apo indirekt i lëndës së tokës në materie trupi njerëzor nuk duhet të tingëllojë si një gjë e huaj për këdo që mediton në faktet në fjalë. (shënim i përkthyesit)

përfundimtare që është dalja e embrionit njerëzor nga barku i nënës për në jetën e kësaj dynjaje; pra duke parë thjesht tek faza spermatozeidale e embrionit njerëzor dhe nëse nuk i merrë në konsideratë të gjitha këto që përmendëm më lartë, kurrë nuk do të mund ta hetosh dhe gjesh qëllimin e vërtetë të ekzistencës së spermatozeidit. Përse?

Sepse shembulli yt në këtë rast është si shembulli i një personi të cilit i mundësohet të shikojë vetëm fazën e parë të prodhimit të ndonjë makinerie dhe jo më tepër se kaq, ndërkohë që ai nuk ka asnjëfarë njohurie për ciklet e prodhimit të makinerisë në fjalë... Shikon ca llamarina, hekura dhe tela që formësohen... Mendon se për çfarë mund të duhen... Dhe në përfundim arrin në konkluzionin se asgjë prej gjëje nuk mund të bëhet me to...

Por, nëse ai do të priste derisa të plotësoheshin fazat vijuese të prodhimit të makinerisë, atëherë do të thoshte: "Po! Tani e kuptova..."

Kështu pra, nuk mund të kuptohet qëllimi i vërtetë i diçkaje që kalon nëpër disa faza, vetëm se pasi të plotësohen të gjitha këto faza.

Që ky fakt të bëhet edhe më i qartë ju ftoj më që të meditonit në lidhje me shembullin e mëposhtëm: "Tregohet se një person, hyn në një shtet të huaj nga aeroporti. Në njërin prej rrugëve që lidhte aeroportin me qytetin, teksa zbrit nga taksia, shikon sesi një bandë kriminelësh kapin një person në rrugë dhe fillojnë ta rrahin mizorisht. Më pas e vrasin, e shtypin me makinë dhe së fundi largohen me shpejtësi. E gjithë kjo ndodh përpara syve të tij dhe as policia e askush tjetër nuk duken gjëkund. I tmerruar i thotë shoferit të taksisë: Më kthe mbrapa! Mbrapa! Mbrapa!... Kthehet në aeroport dhe i hipën avionit më të shpejtë për në vendin e tij... Kur kthehet në vendin e tij e pyesin: Hé! Si t' u duk vendi ku ishe? Përgjigjet: Zot na

ruaj çfarë vendi! Vijnë një grup njerëzish, e kapin njërin, e rrahin, e vrasin, e shtypin me makinë dhe as policia e askush tjetër nuk u duk fare...”

Personazhi i historisë sonë gaboi në opinionin që dha për shtetin që vizitoi, sepse ai gjykoj për të, nisur nga një fragment i vetëm që dëshmoi në atë vend. Por, nëse do të kishte pritur edhe ca dhe do të kishte parë sesi pas pak në vendngjarje do të vinin makinat e policisë, do merrnin në pyetje dëshmitarët okularë, do të hetonin çdo gjë, do grumbullonin fakte e dëshmitarë dhe në një kohë rekord do t’i kapnin kriminelët, do t’i sillnin para drejtësisë dhe do t’u jepnin ndëshkimin e merituar, atëherë do të merrte një imazh të plotë për forcën e drejtësisë ligjore të këtij shteti dhe kurrsesi nuk do të kishte dhënë një opinion negativ për këtë vend...

Fakti se ne jetojmë vetëm njërin fazë prej fazave të shumta nëpër të cilat kalon ekzistenca jonë, është edhe shkaku pse realiteti i ekzistencës njerëzore ka ngelur ende një mister në mes shumë njerëzve.

Ky është edhe sekret i humbjes dhe ateizmit - mosbesimit- të shumë njerëzve, si dhe sekret i dobësisë tek shumë muslimanë të dobët...

Pra nëse lind pyetja se përse njerëzit kanë rënë në këtë gabim kundrejt kuptimit të mirfilltë të realitetit të jetës, përgjigjja është: Sepse ne njerëzit jetojmë vetëm një fazë prej fazave, një periudhë prej periudhave nëpër të cilat kalon ekzistenca njerëzore, dhe tek kufizimi i mendimit në këtë fazë, pikërisht këtu qëndron gabimi dhe mangësia.

Si gjykon për një pjesë të diçkaje pa u plotësuar pjesët pasuese të saj? Si gjykon për një fazë të diçkaje pa u plotësuar njohuria jote për fazat vijuese të kësaj gjëje? Si gjykon për një diçka nisur nga një periudhë e vetme

prej periudhave të shumta nëpër të cilat kalon ajo dhe pa e kompletuar mendimin duke parë tek të gjitha periudhat pasuese të saj.²

Pikërisht kjo është humbja në të cilën ka rënë njeriu.

Sa shumë është për të ardhur keq e për t'u pikëlluar?!

Ajo që sjell edhe më tepër hidhërim tek ky njeri i humbur është se ai e kupton realitetin dhe qëllimin e gjërave me të cilat vepron, e di realitetin dhe qëllimin e shumë prej krijesave dhe gjërave përreth tij, kurse realitetin dhe qëllimin e ekzistencës së vet nuk e di...

Aq sa dëgjuam, që shkrimtari me famë botërore Alekses Karel, një prej mjekëve, filozofëve dhe mendimtarëve më të shquar të Francës, të shkruaj librin "Njeriu. Ky mister i madh.", ku nuk arrin të japë ndonjë përgjigje konkrete për qëllimin final të ekzistencës së njeriut. E si ai ka shumë e shumë të tjerë...

Shkencëtarët e mjekësisë për shembull, ndërkohë që për çdo ditë shtojnë njohuri të reja në njohuritë e tyre për anën fiziologjike -materiale- të trupit të njeriut, vazhdojnë të ngelen krejt injorantë në lidhje me vetveten e tyre, me shpirtin njerëzor, me periudhat dhe fazat vijuese drejt të cilave njerëzimi marshon...-

Kështu njeriu, edhe pse u ngjit në majat e shkencës, mbeti krejt injorant në lidhje me vetveten e tij...

² Shembulli i njeriut të këtillë është si shembulli i personit që shikon një film serial dhe ende pa mbaruar seritë e fundit kërkon të jap përgjigje të prerë në lidhje me përfundimin e tij...

(shënim i përkthyesit)

Kjo është fatkeqësia më e madhe... të bjerë dhe humbasë njeriu në të tillë verbëri e kotësi në lidhje me vetveten e tij...

Allahu i Lartësuar në fjalën e Tij, Kuranin Fisnik, mosbesimtarët i ka përshkruar kështu:

“Ajo që ata dinë në lidhje me jetën e kësaj bote, është dije e cekët, ndërsa për jetën e përjetshme (ndaj Ahiretit -Botës Tjetër-) ata janë plotësisht të shkujdesur.” Er-Rum (7)

Pra, ata dinë të dukshmen e kësaj bote, jo të vërtetën dhe thelbin e saj... Pakujdesi...

Në fakt asnjë rrugë tjetër nuk do t'i japë përgjigje njeriut për qëllimin e vërtetë të ekzistencës së tij, përveçse nëse ai do ta marrë këtë përgjigje nga Krijuesi i tij që e krijoi qenien njerëzore të tillë që ekzistenca e saj të kalojë nëpër faza të njëpasnjëshme. Nuk ka rrugë tjetër përveç kësaj.

Fazën e ardhshme nuk e dimë dhe nuk mund të pyesim për të vetëm se Atë që e transferon njeriun nga një fazë në tjetrën...

Ajo që e shton edhe më tepër dyshimin dhe hezitimin tek njeriu që mundohet ta shpjegojë vetë pse-në e ekzistencës së tij, është se faza që vijon pas kësaj jete është faza e zbërthimit, shpërbërjes, rikthimit të trupit të njeriut në dhé, origjinën nga ku erdhi, pra faza e vdekjes.

Njeriu e shikon jetën teksa fillon të formohet...

Vjen në ekzistencë qeliza e parë njerëzore si pasojë e bashkimit të spermatozoidit me vezoren. Kësaj qelize i bashkangjitet në vazhdim lënda ushqyese që vjen nga toka dhe së fundi i bashkangjitet edhe shpirti dhe prej bashkimit “qelizë-materie tokësore-shpirt” formohet qenia e kompletuar njerëzore.

Më pas vjen vdekja dhe i shpërbën këto bashkime.

Mendojnë pas kësaj se kjo shpërbërje dhe ky rikthim i gjërave në gjendjen fillestare në të cilën ishin, është fundi dhe asgjësimi total...

Sa thamë më lart na bën me dije se në çfarë injorance të madhe ka rënë njerzimi kur jeton një jetë të cilës nuk ia di qëllimin...

Madje shkon edhe më larg se kaq. Mohon që ekzistenca e njeriut në këtë botë të ketë ndonjë qëllim.

Në këtë realitet të hidhur përfunduan njerëzit kur nuk denjuan të udhëzohen nën Udhëzimin Islam të ardhur direkt nga Allahu, Krijuesi i njeriut dhe çdo gjëje në univers.

Ndërkohë, ka njerëz të tjerë që thonë se as që ka jetë tjetër pas vdekjes. Thonë se kjo fazë -vdekja- është fundi i të gjitha fazave. Është e vërtetë që kemi jetuar në disa faza të tjera para vdekjes, kemi qenë dy gjysmash -njëra tek babai e tjetra tek nëna-, kemi qenë dikur në brendësinë e barkut të nënës, pastaj kemi ardhur në këtë botë si krijesa të dobëta, foshnje delikatë, pastaj fëmijë, pastaj adoleshentë, pastaj të rinj, pastaj të rritur, pastaj pleq... E vërtetë. Mëse e vërtetë. Këto faza dhe periudha në të cilat kaluam i njohëm dhe konstatuam e pamë se çdo fazë nga këto vijonte në një fazë pasuese. Kuptuam gjithashtu se nuk mund të mësohet realiteti dhe qëllimi i një faze prej këtyre fazave, vetëm se pasi ta njohësh dhe marrësh në konsideratë fazën pasuese që vijon pas saj. E kuptuam gjithë këtë... Porse, me vdekjen, vjen fundi.

Ka të tjerë që shpikin për veten e tyre qëllime... Sepse askush nuk mundet të jetojë në këtë jetë pa ndonjë qëllim dhe nuk ngelet veçse, të jetosh për qëllimin e saktë për të cilin je krijuar, ose të shpikësh për jetën tënde një qëllim. S'ka mundësi që të mund të jetohet pa ndonjë qëllim. Përse? Sepse njeriun, Krijuesi i Gjithëdijshtëm, Allahu i Lartësuar, e krijoi në një natyrë të tillë që të ecë pas konkretizimit dhe përmbushjes së qëllimeve, dëshirave

dhe objektivave të caktuara. S'ka asnjë njeri me mend në kokë që të ecë në këtë jetë pa patur në kokë një qëllim...

Kështu, njeriu që nuk arrin të mësojë qëllimin e vërtetë të ekzistencës së tij, detyrohet të nxjerrë nga koka dhe t'i shpikë vetes qëllim pas qëllimi.

Në lidhje me këtë disfatë ku ka rënë mendja njerëzore na mjafton të marrim për shembull filozofin francez me famë botërore Mishel, që në kohën e tij konsiderohej mendja e Francës.

Ky filozof ekzistencial -që besonte vetëm në ekzistencën e hetuar nga shqisat- filloi të mendonte në lidhje me jetën e kësaj bote. Cili është qëllimi i saj? Cili është realiteti i saj? Nuk arriti të konstatojë në mendjen e tij asnjë qëllim për të. Nuk arriti të gjente një qëllim të dukshëm për këtë jetë.

Pas kësaj shpiku filozofinë e tij se:

Qëllimi i vërtetë i njeriut në këtë botë është që të vdesë, që të zgjedhë vdekjen. Përse? Sepse faza që na pret është vdekja. Ti tani, përderisa patjetër po shkon drejt vdekjes, më e mira gjë që ke në dorë është që ta zgjedhësh me dëshirë vdekjen, të vetëvritesh. Kaq... Pra ky është qëllimi i kësaj ekzistence. Që ti të zgjedhësh vdekjen. Pastaj vazhdoi: Sepse është e kotë që të vazhdosh të jetosh. Vazhdimi i kësaj jete s'është veçse mundim, injorancë, budallallëk, vuajtje dhe zënka. Çfarë pret nga kjo jetë?! Pret që t'i bësh të tjerët të vuajnë ose ata të të bëjnë të vuash. A nuk është ky rezultati i kësaj jete?! Me fjalë të tjera, jeton dhjetë ose pesëmbëdhjetë vjet, ose më shumë, e sa më shumë që jeton aq më shumë mbushet dosja jote me armiqësitë e tua kundër të tjerëve dhe dosja e të tjerëve me armiqësitë e tyre kundër teje, aq më tepër shtohen vuajtjet dhe pikëllimet. Që të vazhdosh të jetosh kështu, ky s'është veçse një budallallëk. Si do të vazhdosh ta

ngarkosh dosjen tënde dhe atë të të tjerëve?! Më e mira gjë është që t'i lehtësosh këto vuajtje dhe pikëllime tek vetja dhe të tjerët. Shkurto punë!...

Mirë. **Kjo është e para.**

E dyta: Tha: Ti o njeri lufton në një luftë të humbur. Krejt si një ushtarak në një luftë që e di se është i humbur, por prapë vazhdon të luftojë dhe bëjë rezistencë. O i marrë! Pse këmbëngul dhe vazhdon të luftosh?! Kjo këmbëngulje jotja s'është veçse shtim vuajtjesh. Dorëzohu dhe mjaft.

Kështu, ti o njeri në këtë jetë je i dënuar me vdekje. Përse gjithë kjo këmbëngulje për të jetuar?! Përse?! Është një luftë kjo që ka datuar me humbje për ty qysh ditën kur u linde. Që atë ditë ti linde për të vdekur. S'ka ngelur asgjë në dëshirën tënde...

Mirë. Po konkluzioni i kësaj filozofie?

Konkluzioni i kësaj është se kjo dynja -sipas Mishelit- nuk ia vlen të qëndrosh në të. Nuk është reale. Më e mira gjë për ty o njeri është që sa më shpejtë të zgjedhësh çastin dhe rastin ku të mund t'i japësh fund asaj. Rasti më i mirë -këshillë prej Mishelit- është kur ta shohësh vetveten në momente të lumtura. Ky është edhe momenti më i përshtatshëm për t'i dhënë fund asaj. Dhe po që se sheh ndonjë nga të afërmit apo shokët e tu të lumtur, dhurata më e bukur që mund t'u bësh është që t'i japësh fund jetës së tyre pikërisht në këtë mënyrë...

Dhe e bëri këtë gjë në realitet. Një ditë të bukur, kur pa gruan e tij në kulmin e lumturisë me të, tha me vete: Tani është momenti për t'ia bërë asaj dhuratën. Mori një thikë dhe e vrau. Pas krimit që bëri, pa vonesë u dorëzua në komisariatin e policisë pranë lagjes së tij. U paraqit tek shefi i rendit dhe i tha: Unë jam Misheli. Shefi me respekt i tha: Si? Filozofi Mishel?! Misheli ia ktheu: S'ka kohë për të humbur. Bëj punën tënde. Shefi

e pyeti i çuditur: Çfarë ka ndodhur? Tha: Kam vrarë gruan time sipër krevatit të saj. Kjo është thika dhe në të është gjaku i saj.

Shefi i rendit u çorodit, u pushtua nga një ndjesi frike e nuk diti çfarë të bënte. Çfarë do të bëhej me të nëse do të arrestonte Mishelin, mendjen e Francës?! Gazetat do ta sulmonin ashpër?! Pastaj e mblodhi veten dhe mendoi: Patjetër duhet të marr mendimin e ministrit të brendshëm. I telefonoi. Edhe ministri i brendshëm si ky i pari pati frikë dhe kërkoi mendimin e presidentit të Republikës. President i Francës në atë kohë ishte Zhiskar D'Estë...

Kjo histori ka ndodhur në kohën e tij, pra në një kohë jo shumë të largët. Zhiskar D'Estë tha: Shikojeni në është i dehur... Po qe se është kështu atëherë për të ka zgjidhje. Pasi krimi apo faji që bën i dehuri ose i çmenduri -sipas ligjeve njerëzore perëndimore- mund të mos gjykohet, ose së paku mund të lehtësohet... Pastaj vijoi: Por edhe nëse nuk është i dehur, është turp për Francën që të arrestojë mendjen e saj. Turp për Francën që të arrestojë mendjen e saj...

Pra ky ishte mendja e Francës. Si ta fusnin në burg?! Mirëpo cila është zgjidhja e Zhiskar D'Estë? Patjetër duhej gjetur një zgjidhje ligjore. Ai tha: Dërgojeni në spitalin psikiatrik!... Pra sipas mendimit të vetë presidentit të Francës, vendi i "mendjes" së Francës, ishte, spitali i të çmendurve...

Ky është vetëm një shembull që nxjerr dukshëm në pah humbjen, mëdyshjen dhe hezitimin perëndimor për jetën.

Ky filozof në gjysmën e çështjes i përngjan besimtarit më modest që është i mendimit se kjo botë është e përçmuar dhe joreale. Kështu ky arriti në gjysmën e rrugës. Kjo botë për ç' duhet?! Nuk është gjë... Por ai duke qenë

i paditur në lidhje me fazën pasuese të kësaj bote, gaboi dhe ra në humbje.

Dhe çudia më e madhe është se një student egjiptian, ndoshta pak vite pas kësaj ngjarjeje, të njëjtën gjë si Misheli, vendosi t'ia bënte dy prindërve të vet. Babai i tij ishte një nënpunës i lartë, kurse nëna e tij, punonte në televizion. Në mesnatë, i pa ata të dy të lumtur dhe i vrau që të dy. Këtë lajm e publikuan gazetat dhe unë e kam lexuar me këto dy sy.

Kjo është një formë prej formave.

Një tjetër e quan këtë botë vend argëtimi. Në fakt i gjithë "qytetërimi" perëndimor e mendon këtë jetë se ajo s'është veçse epshe dhe qejfe që duhen shfrytëzuar dhe ngopur sapo të jepet mundësia. Nxito përpara se të të sulmojë vdekja. Edhe kolonizimet, persekutimet, komplotet, krimet dhe padrejtësitë që kanë mbushur tokën, shkak i tyre s'është tjetër përveçse kjo ide që thotë: S'është kjo botë veçse epshe dhe qejfe. Vetëm kaq. Shfrytëzoji rastet për të përmbushur epshet dhe qejfet e tua, përpara se të të vijë vdekja. Shiko kënaqësinë personale dhe kaq. Merr prej të tjerëve ç'të mundesh duke ndjekur çdo lloj rruge. Mjaft që të përmbushësh epshet e tua.

Përveç frikës nga "ligji i xhunglës", ata nuk i frenon në këtë "ide" të tyre ndonjë gjë tjetër si feja, morallet etj. Prandaj do t'i gjesh politikanët mosbesimtarë të thonë haptazi se: Në politikë nuk ka diçka që ta ketë emrin parime stabile -të pandryshueshme-, por gjendet një diçka që e ka emrin interesa stabile. Interesa, realizim ambiciesh. Po qe se kam interes të jem me ty, unë jam me ty, e nëse kam interes të jem kundër teje dal kundër teje. Pse jo? Edhe mund të të vras. Përse? Sepse kështu ma kërkon interesi...

Kjo pra është vorbulla ideore dominuese sot, e në të po humbet njerëzia.

-Vërtetësia e Jetës-

Për fat të keq, kësaj vorbulle ideore i përkasin pjesa më e madhe e filozofëve dhe liderëve të mbarë botës, të cilët janë të paaftë të kuptojnë dhe konceptojnë qëllimin dhe realitetin e kësaj jete... Sepse realiteti i jetës dhe ekzistencës njerëzore nuk mund të mësohet kurrë duke e ngurtësuar mendimin në një fazë prej fazave të kësaj ekzistence.

Ky realitet nuk mund të mësohet përveçse nga Ai që të transferon ty o njeri nga një fazë në tjetrën. Atij i duhet drejtuar: *O Ti që më krijove nga një pikë e vogël uji e përçmuar dhe e zhvillove atë nëpërmjet lëndës ushqyese të tokës! Ja ku e plotësove dhe përsose krijimin tim dhe i nënshtrove për mua mbarë ligjësitë, edhe qiellin, edhe tokën. Më dhe kaq shumë mirësi. Më pasurove dhe dallove duke më pajisur me logjikë. Më bërë krijesë të ditur... Ku do të shkoj pas kësaj?...*

Përgjigjja për këtë pyetje nuk mund të merret përveçse nga Ai, ose përndryshe të pret humbja dhe hezitimi, gjë në të cilën ka rënë pjesa dërmuese e njerëzimit sot.

Le ta trajtojmë së bashku këtë temë!

- Cili është në të vërtetë qëllimi i jetës?

Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:
“A menduat se Ne u krijuam më kot...?!”

El-Muminun (115)

A u krijua njeriu më kot?!

Jo! Allahu nuk e krijoi njeriun kot dhe nuk do të lejojë që njeriu të vdesë dhe zhduket pa kurrfarë përgjegjësie.

A nuk e shikon se syri yt nuk u krijua kot por për një qëllim, se veshi yt nuk u krijua kot por për një qëllim, se duart e tua nuk u krijuan kot por për një qëllim, se arteria më e vogël e gjakut në trupin tënd nuk u krijua kot porse u krijua për një qëllim...?!

2- Bindja e krijuar ndër disa njerëz se njeriu është krijuar kot.

Paria njerëzore dhe pjesa dominuese e njerëzisë sot, qëndron mbi parimin se njeriu është krijuar kot.

Pikërisht rrëzimi nga themelet i këtij parimi të rremë të pretenduar nga ateistët është një nga çështjet primare së cilës duhet t'i japin përparësi të veçantë mbarë dijetarët dhe thirrësat islam.

Për fat të keq ky parim dritëshkurtër ka pushtuar mendjet dhe shpirtërat e elitës, pedagogëve, filozofëve dhe mendimtarëve në përgjithësi. Janë pikërisht këta që e nxorën dhe përkrahën parimin në fjalë.

Dyndja e artikujve dhe shkrimeve që mbushin sot librat, gazetat, revistat dhe median mbarë, vërshon duke bartur këtë ide që përplaset drejtpërsëdrejti me shtyllat bazë të besimit njerëzor në Zot dhe në Botën Tjetër.

Pikërisht rrëzimi nga themelet i këtij parimi të rremë të pretenduar nga ateistët; zbulimi i pavërtetësisë së tij në sytë e masave dhe publikimi i fakteve të vërteta që i përgënjeshtrojnë këto fantazi pa fre, është një nga çështjet primare së cilës duhet t'i japin përparësi të veçantë mbarë dijetarët dhe thirrësat islam.

Madje them se ata që janë ndikuar nga ideja se njeriu jeton kot, i përngjajnë një personi që qëndron zhytur në mendime rreth një çështje të caktuar që e preokupon së tepërmi, e ndërkohë që ti i flet, ai kushedi se ku e ka mendjen, tek tregtia, gruaja, fëmijët...

Ti i thua atij se fjala dhe vepra më e bukur është të flasësh dhe veprosh nën bindjen se nuk ka zot tjetër që e meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut... E kur e pyet se ç' mendim ka për sa the, të thotë: Hë? Çfarë po thojë?...

Kjo ndodh sepse ata nuk e vrasin mendjen për fenë. Kanë ndërmarrë një vendim të brendshëm. Mendojnë në heshtje se për këtë jetë nuk ka asnjë qëllim dhe se njeriu jeton dhe ekziston kot...

Prandaj, goditja e kësaj ideje, zbulimi i pavërtetësisë së saj dhe paraqitja e realitetit para njerëzve, është ilaçi më primar. Syri, dora, fytyra, zemra, mushkëria, rrjeti i kapilarëve të gjakut, çdo qelizë në trup, a janë krijuar kot apo kanë ndonjë qëllim të caktuar?! Përgjigjja dihet: Të gjitha ato janë krijuar për një qëllim të caktuar. Ajo që shpjegon qëllimin dhe rolin në trup të çdonjërit prej këtyre, quhet shkenca e funksionimit të organeve. Detyra e mjekut është që nëse tek ndonjë prej këtyre përbërësve të trupit qëllimi nuk realizohet për ndonjë defekt apo anomali të mundshme, ai ta riaftësojë atë që të kryejë rolin apo qëllimin për të cilin është krijuar...

Në një bisedë që pata me profesorin ateist anglez Krostofer Baris rreth çështjes se a janë krijuar pjesët përbërëse të trupit për një qëllim të caktuar, ai u përgjigj pa ngurim: Sigurisht. I thashë: Pra pjesët përbërëse të trupit kanë një qëllim të caktuar. Ma ktheu: Po. I thashë: A është ky qëllim vetiak. Qeshi... Ngase kishte dëgjuar për mua nga kolegët e tij të tjerë, dhe nisur nga ç'kishte dëgjuar, vetë ai kishte insistuar të takohej me mua. Kur dëgjoji prej meje të flas këto fjalë qeshi si të donte të thoshte: A ky është personi për të cilin më kanë folur aq shumë?!... Zoti e di se përse qeshi. Ndoshta për sa thashë, ndoshta për diçka tjetër. Ashtu me buzë në gaz tha: Si thua? Po të merrnim vetëm aparatën e tretjes: gojën, ezofagun,

stomakun, zorrën e trashë, pankreasin, mëlçinë..., po të merrnim vetëm këtë aparat të palidhur me trupin, për çfarë do të hynte në punë?! I thashë: Nuk do të hynte në punë. Tha: Atëherë si të themi se pjesët përbërëse të trupit i shërbejnë vetvetes. Qëllimi i tyre është i tillë që ata t'i shërbejnë tërësisë së trupit... I thashë: Faleminderit. Unë të pyeta profesor dhe ti m'u përgjigje... Pasi ra dakort se pjesët përbërëse të tërësisë trupore funksionojnë në interes të tërësisë së trupit i thashë: Mirë. Po tërësia trupore e quajtur njeri, për çfarë qëllimi jeton?... Si të marrësh një vare dhe ta godasësh në kokë dikë. Kështu u ndie. E gjithë filozofia e tyre ateiste ngrihet mbi parimin se njeriu jeton kot e pa qëllim, kurse vjen ky burrë dhe nxjerr se për të paska një qëllim... U kthye nga unë dhe më tha: Kjo është filozofi... Kjo është filozofi. Sepse tek ata filozofia ndryshon nga shkenca. Shkenca është një gjë e prerë në të cilën s'ka vend për dyshim, kurse filozofia është një supozim që mund të jetë i saktë por mund të jetë edhe i pasaktë. Pra tha: Kjo është filozofi. I thashë: Kjo është shmangie. U shmange, u shmange profesor. Pak më parë ishte shkencë... Ishte shkenca e funksionimit të organeve që thotë se çdo pjesë përbërëse e trupit funksionon në interes të tërësisë së trupit, e kur të pyeta për tërësinë e trupit u shmange dhe dredhove...

Doja që t'i jepja një shuplakë të dytë. I thashë: Më ka ngelur edhe një pyetje tjetër o profesor. Tha: Të lutem. I thashë: Këpuca jote a ka ndonjë qëllim?...

Ajo që më bën të çuditëm derimëtani është fakti se nuk e di sesi por, ndërkohë që s'e kishte marrë ende veten nga goditja e parë, u përgjigj pa hezitim: Po. Këpuca ime e ka një qëllim. I thashë: Çfarë qëllimi? Tha: Më mbron nga dëmet që mund t'i vijnë këmbës prej sendeve dëmtuese të rrugës, prej të ftohtit... Dhe

filloi të fliste e të fliste. E dëgjova deri në fund e pastaj i thashë: A je i bindur se këpucët e tua e kanë një qëllim. Tha: Shumë i bindur. I thashë: Po ti o profesor çfarë qëllimi ke në jetë? I shkuan mendtë vërdallë rishtazi. I thashë: Për Zotin! Habitem nga "qytetërimi" juaj që u mëson juve, bijve të tij, se ju jeni me mëpak vlerë dhe më të përçmuar se këpucët që vishni. Ç' do akoma. Ide apo program që e ulë njeriun më poshtë se këpucët e tij. Për ekzistencën e këpucëve qënka një qëllim, kurse për ekzistencën e njerëzve jo.

Dhe i quajnë këto broçkulla filozofi, ide... Jo jo! Këto fantazi pa fre, s'janë veçse ide boshe që çojnë në shkatërrim, humbje e kotësi...

Pastaj kujtova fjalën e Allahut të Lartësuar:

"...ata që nuk besuan kënaqen dhe hanë në këtë jetë ashtu si dhe kafshët, e vendqëndrimi i tyre (që i pret në Botën Tjetër) është zjarri." Muhamed (12)

Lopë... bagëti... madje më poshtë akoma.

Edhe pse mund të habitesh, dije se këta ideatorë "të ndritur" janë ata që ligjërojnë dhe vendosin ligjet për njerëzinë... Hë? Kush do t'i vendosë ligjet? Ne do t'i vendosim ligjet -thonë-. Ne do t'i vendosim dispozitat ligjore pikë për pikë. Mirëpo a e dini ju se përse u krijua njeriu? Jo. Nuk e dimë... Pra ti nuk e di se përse u krijua dhe përse jeton njeriu, atëherë me ç' të drejtë do të nxjerrësh ligje për jetën e njeriut?! Sikur të ishte rregulli logjik që injorantit në lidhje me një çështje duhet t'i besohet zgjidhja e kësaj çështje. E kundërta. Tamam e kundërta ndodhi me këta "ideatorë" ateistë. Pikërisht për këtë shkak e mbushën dhe vazhdojnë ta mbushin tokën plot shkatërrim, kotësi e shthurje...

E do të ngelet ky shkatërrim, do të ngelet kjo humbje dhe do të ngelet kjo kotësi deri kur njeriu ta kërkojë udhëzimin nga Krijuesi i tij, i Cili më së miri e

di se përse e krijoi krijesën e Vet. Vetëm kështu do ta mësojë njeriu se përse u krijua dhe vetëm kështu do të marrë drejtim çështja e njeriut, ashtu siç ka marrë drejtim çështja e diellit, hënës, yllit, pemës dhe e gjithë universit, ashtu siç ka marrë drejtim çështja e zemrës dhe mushkërisë...

E për Zotin, nëse zemra jote do rrihte dhe funksiononte sipas vendimeve të parlamenteve apo kongreseve, nëse atyre do u ishte lënë gjë në dorë të luanin me çështjen e mushkërisë tënde..., atëherë do të kishin prishur dhe shkatërruar çdo gjë. Por Allahu i Lartësuar nuk u la atyre dorë të lirë në këto gjëra...

Le të kthehemi edhe njëherë te historia e jetës.

Atëherë, arritëm në faktin se njeriu patjetër që jeton për një qëllim, porse shumë prej njerëzve, fatkeqësisht edhe pse të ditur, nuk e dinë këtë qëllim.

Le të flasim diçka që e bën njeriun të përkujtojë, reflektojë dhe kuptojë.

Pra shumë prej njerëzve, fatkeqësisht edhe pse të ditur, nuk e dinë qëllimin e ekzistencës.

Në të shumtën e rasteve kjo gjë vjen sepse ata pretendojnë se kjo jetë është e kotë dhe pa ndonjë qëllim. Përse? Për arsye se ka prej njerëzve që edhe pse mund të besojnë në ekzistencën e Krijuesit, thonë se Ai e krijoi njeriu dhe universin kot... Tallet pra. Thonë apo nuk thonë kështu, kjo është domethënia. I Lartësuar është Allahu nga çfarë i përshkruajnë injorantët.

Për fat të keq, viktimat të kësaj ideje të gabuar kanë rënë edhe disa muslimanë të dobët, që edhe pse kanë shpallur se e kanë pranuar Islamin për bindje, ata, jo me gojën por me veprën dhe ecejaken e tyre në këtë jetë, veprojnë, programojnë, ideojnë dhe jetojnë nën diktatin e parimit ateist se njeriu jeton kot.

Të parëve, dhe të dytëve, si dhe të gjithë atyre që ende hezitojnë dhe e kanë lënë vetveten e tyre t' i pushtojë kjo vorbull e zezë, u them:

Nëse një person, ose ne vetë, do t'u thonim amerikanëve, perëndimorëve apo rusëve, se doktorët tuaj nuk bëjnë veçse gjëra të kota, s'ka dyshim se, nëse do t'i merrnin në konsideratë fjalët tona, do të na sulmonin mbarë mendimtarët, pedagogët, shkrimtarët, gazetarët, i madh e i vogël. Do na thonin: O injorantë! Ai që rregullon anomalitë dhe defektet e syrit apo zemrës kur sëmuret, ky person tallet?! E do paraqesin argument pas argumenti, do të na sulmojnë pa mëshirë dhe së fundi do na thonë: Sidoqoftë, pranoni apo nuk pranoni, s'ka dyshim se ai që rregullon anomalitë dhe defektet e syrit e të zemrës, mushkërisë apo stomakut... qëndron shumë më lartë sesa të mendohet për të se ai tallet...

Atëherë u themi: i Lartëmadhëruar është Allahu! Ai që rregullon anomalitë dhe defektet e syrit e të zemrës, mushkërisë apo stomakut... qëndron shumë më lartë sesa të mendohet për të se ai tallet, kurse pretendoni se Ai që e krijoi syrin e zemrën, mushkërinë dhe stomakun është tallur?! Kush riaftëson syrin apo zemrën, mushkërinë apo stomakun, qëndron shumë më lartë sesa të mendohet për të se ai tallet, kurse Ai që i krijoi të gjithë organet e trupit dhe tërësinë e njeriut, e bëri këtë gjë kot, duke u tallur?!

I Lartësuar është Allahu nga çfarë i përshkruajnë Atij mosbesimtarët e paditur.

Prandaj Allahu i Lartësuar thotë në fjalën e Tij, në Kuranin Fisnik:

“A menduat se ju krijuam pa asnjë qëllim, dhe se nuk do të ktheheni tek Ne?! I Lartësuar është Allahu, Sunduesi, i Vërteti. Nuk ka zot tjetër veç Tij. Ai është Zoti i Arshit Madhështor.”

El-Muminun (115-116)

Allahu është më i Lartësuari. Ai qëndron shumë më lart sesa të mendohet për Të se Ai bën diçka pa ndonjë qëllim...

3- A është qëllimi i ekzistencës njerëzore i njëjtë për të gjithë njerëzit?

Sa bukur pra! Ky është këngëtar, qëllimi i jetës së tij është të këndonjë. Ky tjetri revolucionar, qëllimi i jetës së tij është revolucioni. Tjetri poet, thur vargje e strofa, qëllimi i jetës së tij është poezia. Po ti tjetri? Unë... E rëndësishme.

Secili ka vendosur për vetveten e tij një qëllim sipas kokës së vet apo kokës së një tjetër njeriu të ashtuquajtur filozof.

Shumica e njerëzisë kështu është sot. Mendon se krijimi i njeriut është i paqëllimtë. Çdokush përpilon qëllime nga koka e tij...

Në po këtë vorbull kanë rënë edhe shumë prej muslimanëve dhe që këtu jeta e muslimanëve mori tatëpjetën. Nuk thonë se njeriu u krijua pa qëllim. Jo, jo. Thonë: Allahu na krijoi për një qëllim. E dimë. Por kur shikon realitetin e sjelljeve dhe të jetuarit të tyre gjen se çdokush ka përpiluar dhe vendosur për jetën e tij një qëllim nga koka e tij. Ky do presidencën... gjatë gjithë jetës së tij ngulmon me mish e me shpirt për të ruajtur postin. Kurse ky tjetri do paranë... gjatë gjithë jetës së tij vrapon pas saj... para, para, para. Tjetri do të bëhet dijetar me nam, tjetri zyrtar, tjetri të ngjitet në gradat e prestigjit dhe pozitës, tjetri qejfet, tjetri...

Çdokush ka projektuar për veten e tij një qëllim. Sikur krijimi dhe ekzistenca e qenies së tyre -ku në fakt reflektohet dhe mishërohet denjësisht përsosmëria

krijonjëse- të ishte një send i gjetur, i pavlerë, të cilit gjithsecili mundohet t'i sajojë ndonjë qëllim a funksion, sa për të mos shkuar kot, ashtu, nga një derë tjetër.

Shembulli i tyre është si shembulli i dikujt që i bie në dorë një magnetofon. E merr atë, shkon tek shokët e tij e u thotë: O djema! Ç' mendim keni t'i bëjmë një qëllim këtij magnetofoni? Çfarë thoni ta bëjmë? Ia pret njëri: Ç' mendim keni sikur ta bëjmë portofol. Ia kthen tjetri: Jo, jo. Më mirë ta bëjmë çantë... Derisa vjen një njeri i gjykueshëm e teksa i dëgjon në këtë debat të çmendur u thotë: Çfarë po bëni?! Po ja, -ia presin-, po i vendosim këtij magnetofoni një qëllim. U thotë i çuditur: Si?! Po i vendosni atij një qëllim?! Po a nuk e dini se atij ia ka vendosur qëllimin prodhuesi i tij, që kur ai ishte në projekt³ përpara se të

³ Sigurisht, njeriu jo vetëm që nuk mund t'ia ndërrojë tërësisht qëllimin magnetofonit ashtu që ta bëjë nga magnetofon çantë apo diçka tjetër, por edhe sustat e komandimit të magnetofonit që gjenden mbi të është i detyruar t'i përdorë siç i ka caktuar projektuesi dhe prodhuesi i këtij magnetofoni. Susta "play" për shembull, është për ta vënë në punë kasetën dhe jo për të incizuar, ashti siç susta "rec" është për të incizuar e me të nuk mund të vihet në punë kasete dhe as mund të kthehet, ndalohet apo t'i bëhet diçka tjetër. Ai që do t'ia ndryshojë funksionimin këtyre sustave -aq më tepër tërë magnetofonit- duhet ta projektojë e prodhojë vetë fillimisht në përputhje me funksionimin që dëshiron, e vetëm pas kësaj mund ta përdorë si do. Por, pasi atë e ka projektuar dhe prodhuar dikush të funksionojë në një formë të caktuar, nuk ngelct veçse të përdoret në përputhje me funksionimin që i ka vendosur projektuesi dhe prodhuesi i tij. Kurse përndryshe, përveçse njeriu do të akuzohet me injorancë (nëse për shembull e përdor magnetofonin për çantë, frigoriferin e ri për raft buke...etj), ai edhe do të dështojë (si për shembull ai që për të incizuar një kasetë magnetofoni në vend që të shtyp sustën "rec" shtyp sustën "play") e edhe do prish (si për shembull ai që për ta vënë në punë kasetën në vend

bëhej, e ai qysh ditën që është bërë punon dhe funksionon sipas këtij qëllimi dhe standarti të caktuar. Nëse doni t'i bëni atij një qëllim tjetër, atëherë more kampionë, prodhojeni ju fillimisht...!

Po kështu, gjithkush që do t'i përpilojë vetvetes një qëllim sipas qejfit, duhet fillimisht, që ta vetëkrijojë veten e tij në përputhje me qëllimin që dëshiron. Mirëpo duke qenë se atë e ka krijuar Allahu, le ta dijë se krijimi i tij nuk është i mundshëm përveçse për atë qëllim për të cilin Allahu e krijoi.

Pra një njeri që shpik qëllime për jetën e tij nga koka e vet nuk ka kurrfarë të drejte?! Njeriut s'i ngelet veçse të ecë pro dëshirës së Atij që e krijoi dhe nuk i ngelet veçse t'i bindet këtij qëllimi për të cilin u krijua, sepse çështja e tij ka marrë fund qysh ditën kur Allahu vendosi që ta krijonte.

Pikërisht në lidhje me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për tjetër, përveçse që të më adhurojnë Mua.”

Edh-Dheriat (56)

Mbaroi puna. Çështja jote u vendos nga Krijuesi dhe krijimi yt erdhi në përputhje të plotë me këtë qëllim dhe vendim suprem hyjnor.

Por çudia qëndron në atë se çdokush formulon në kokën e tij një qëllim për vetveten. Ky adhuron shkencën dhe diturinë, ky adhuron pozitën e tij, ky tjetri të afërmit e tij, ky epshin dhe qejfin, ky paranë, ky dynjanë...

= që të shtyp sustën “play” shtyp sustën “rec”). Kështu, -e për Allahun është shembulli më i lartë-, njeriu, kjo krijesë e Allahut, jetën e tij duhet ta bëjë të funksionojë sipas qëllimit për të cilin e ka krijuar Krijuesi i tij, Allahu i Lartësuar, përndryshe ai do bjerë në injorancë, dhe pse jo edhe do dështojë e edhe do prishë, madje edhe gjënë më të çmuar që ka, jetën e tij.

(shënim i përkthyesit)

E çdokush përpilon në kokën e tij qëllime për ekzistencën e tij. Madje kjo gjë është bërë art më vete. Ky thotë se qëllimi i jetës është që raca ariane - gjermane- të dominojë mbi të gjitha racat. A s' ishte kjo ideja hitleriane të cilën bota e pagoi aq shtrenjë.

Dikush tjetër tha fashizmi, dikush tjetër nacionalizmi, dikush komunizmi...

Ç' është kjo?! O njeri, a për këtë qëllim u krijove?!

Shumë filozofi perëndimore bashkëkohore propagandojnë pro idesë se raca e bardhë duhet të qëndrojë mbi të gjitha racat e tjera.

Nga ana tjetër hebrenjtë -çifutët- e konsiderojnë veten populli i zgjedhur i Zotit, kurse për të tjerët thonë se ata u krijuan për të qenë robër të hebrenjve.

Ç' është kjo kotësi?! Kjo është një prishje e çdo forme reale të jetës në tokë. Kjo është prishje e rendit në tokë.

I kthehemi sërish pyetjes sonë: A është qëllimi i ekzistencës njerëzore i njëjtë për të gjithë njerëzit, apo ai ndryshon nga një njeri tek tjetri? Le ta shohim.

Në fakt qëllimi për të cilin u krijua njeriu është i njëjtë tek të gjithë njerëzit. A nuk e shikon se qëllimi i funksionimit të dy syve të tu është i njëjtë me atë të çdo njeriu tjetër, të pasur apo të varfër, epror apo mvarës... Apo syri i presidentit është elektronik, kurse ai i ushtarit ka një strukturë tjetër?! Për Zotin, doktori kur kuron syrin e presidentit, të ushtarit, të pasurit apo të varfërit, i trajton njëjloj. Po po. Syri yt është i njëjtë me atë të çdo të pashkolluari apo shkencëtari, me atë të çdo njeriu të kohës tënde apo të kohëve të shkuara. Gjithashtu edhe qëllimi i funksionimit të çdo pjese tjetër përbërëse të trupit të njeriut është i njëjtë tek i gjithë soji njerëzor, pavarësisht nga koha apo vendi ku kanë jetuar ⁴.

⁴ Le ta sqarojmë këtë fakt me shembullin në vijim. Magnetofonë të një lloji, të të njëjtit projekti dhe modeli, pamvarësisht nga struktura e jashtme, ngjyra dhe kohëndodhja. Atëherë qëllimi i funksionimit të tyre a është i njëjtë apo jo?! Sigurisht që është i njëjtë... (shënim i përkthyesit)

Ashtu si struktura fiziologjike njerëzore, ashtu edhe ajo shpirtërore e mendore është e njëjtë në tërë sojin njerëzor dhe nuk ka ndryshuar me ndryshimin e kohës apo të vendit. Ndjesia dhe mendimi për poshtërimin, krimin, padrejtësinë etj, ka qenë dhe ngelet po ajo.

Pra duke qenë se njerëzit u takojnë strukturave fizike dhe natyrave të njëjta që nuk kanë ndryshuar tek njeriu në varësi të kohës apo vendit, atëherë edhe qëllimi i krijimit të njerëzve duhet të jetë një. Ai nuk duhet të ketë të bëjë as me kohën kur ka jetuar apo jeton njeriu dhe as me vendndodhjen. Nuk ka lidhje as me pozitën e as me opozitën, as me pasurinë e as me varfërinë, as me inteligjencën e as me analfabetizmin.

Por qëllimi i krijimit të njeriut është i lidhur ngushtë me natyrën e brendshme njerëzore dhe strukturën biologjike të trupit njerëzor. Duhet medoemos që qëllimi i krijimit të njeriut të ketë të bëjë direkt me natyrën fikse shpirtërore dhe fiziologjike të tij dhe ky qëllim nuk ka aspak lidhje me pasionet dhe intuitat e ndryshme që ndryshojnë nga një njeri tek tjetri.

Kështu pra, nuk është e drejtë të thuash se ky u krijua për t'u bërë doktor, ky për t'u bërë president, ky për të grumbulluar para e ky tjetri... Jo jo. Duhet patjetër që qëllimi i jetës të jetë i njëjtë për të gjithë njerëzit. Nuk duhet të ngatërrojmë në mes qëllimit dhe mënyrës apo mjetit të jetesës. Pikërisht në lidhje me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“...Kjo është natyra në të cilën Allahu i krijoi njerëzit. Krijimi -kreatura- e Allahut, nuk mund të ndryshohet.” Er-Rum (3)

4- Qëllimi i krijimit të njeriut e kapërcen këtë botë.

Çdo njeri i mençur duhet të meditojë rreth pyetjes se për çfarë qëllimi u krijua.

Nëse për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje ai e ngushton vështrimin vetëm në jetën e kësaj bote, sado që të përpiqet, nuk do të gjejë ndonjë përgjigje bindëse për qëllimin e ekzistencës së njeriut. Vërtitu si e nga të duash dhe do detyrohesh më në fund t'i dorëzohesh idesë së vjershëtorit ateist që me vargjet e tij shpreh qartë hezitimin e tij për vërtetësinë dhe qëllimin e jetës së njeriut, duke thënë:

“Erdha. Nuk e di se nga, porse di që erdha.
Pashë para meje rrugë dhe mbi të unë eca.
Dhe do të ngelem në ecje desha apo nuk desha.
Nga erdha? Nuk e di. Si e pashë rrugën time?
Nuk e di...
E përse nuk e di? Nuk e di...”

Injorancë totale... Kotësi...

Pse ra në këtë mëdyshje dhe hezitim? Sepse nuk di veçse këtë fazë, këtë seri të serialit “ekzistencë njerëzore”.

Mbajeni mend mirë këtë. Do t'ju jap një armë që demaskon çdo qëllim të rremë të vendosur për jetën. Atë që ka shpikur me kokën e tij qëllim për jetën e vet pyeteni vetëm këtë pyetje: Përse vdes? Kaq... U krijova

me qëllim që të grumbulloj para. Mirë... Po përse ti vdes pasi arrite të grumbullosh aq e aq shumë para?!

Unë u krijova me qëllim që të bëhem koka e gjithë botës. Po përse vdes?! Kjo është një pyetje që nxjerr në pah pavërtetësinë e çdo qëllimi të gënjeshtërt që është vendosur për jetën. Përgjigju pra! Përse vdes? Pse pra vdes? Do të bëhesh poet? Atëherë përse vdes? Të bëhesh kërcimtar? Atëherë përse vdes? Do të bëhesh pasanik të sundosh pasuritë e botës. Atëherë përse vdes?

Me këtë pyetje bien poshtë të gjitha qëllimet e rreme që kanë vendosur njerëzit për këtë jetë, sepse këto qëllime janë ndërtnuar duke u ngurtësuar vetëm mbi fazën e kësaj bote.

Nëse njeriu thotë se qëllimi i ekzistencës së tij është jeta, atëherë përse ai vdes? Qëllimi është puna, atëherë përse e gjejmë njeriun të paaftë për të kryer çdo punë, dhe së fundi përse vdes kur ende i kanë ngelur plot punë për të bërë? Kënaqësia..., atëherë përse njeriu vdes pa i përmbushur ambiciet e tij, përse i ndodhin fatkeqësi, vdekje, sëmundje, gjëra këto që e bëjnë njeriun të dalë nga kjo botë i pakënaqur? Lufta për përmirësim, atëherë përse gjendja e njerëzve sa vjen e shkon drejt keqësimit dhe së fundi përse njerëzit dalin nga kjo jetë ende pa e realizuar dhe përjetuar përmirësimin?

Po t'i pyesësh disa njerëz përse u krijuan të thonë për të jetuar. Mirë, por nëse vërtetë ti u krijove në këtë dynja për të jetuar, atëherë përse vdes? Përderisa ti je krijuar për një qëllim, krahas realizimit të këtij qëllimi duhet edhe vazhdimësia e ekzistencës tënde në përputhje me këtë qëllim.

Ti thua jeta u krijua për këtë qëllim. Atëherë duhet:

Së pari, që ekzistenca jote të jetë natyrizuar, që në fillimet e saj e në vazhdim, në një formë të tillë që

konkretizimi i qëllimit të pretenduar të arrihet krejt natyrshëm dhe pa stërmundime e sajime.

Së dyti, lypset stabilizimi dhe vazhdimësia e ekzistencës së njeriut në përputhje me këtë qëllim. Sepse vetëm kështu mund të konsiderohet se qëllimi është përmbushur.

Thotë: Për t'u kënaqur. Mirë, por përse pakënaqësirat... e së fundi përse vdes. Mos vallë vdekja është burim kënaqësie për njeriun?! A është vdekja -kjo ligjësi sfiduese- me trajtat e ndryshme të saj fenomen që ndërton apo që shkatërron shoqëritë dhe kombet?!

Lufta për përmirësim. Komunistët këtë e kishin qëllimin e jetës së tyre. E quajtën lufta e shenjtë e klasave. Mirë, luftuan e luftuan... e së fundi asgjë nuk përmirësuan, përveçse prishën e shkatërruan. Donin të vendosnin barazinë sociale, por nuk shtuan vetëm se disekuilibrin social dhe përqëndrimin e pushtetit në dorën e një grushti njerëzish... Shkurt dështuan! Argumenti më i mirë për këtë është disfata që pësoi komunizmi pasi i shkaktoi aq shumë viktima e pasoja të kobëshme njerëzimit...

Teksa i pyesim këta njerëz për qëllimin e ardhjes së tyre në këtë botë gjejmë se përgjigjet e tyre janë të shumta..., por aspak shpjeguese për vërtetësinë e jetës.

Shembulli i këtyre personave është si t'u thuhet disa studentëve: Çfarë u solli në universitet? Thonë: Erdhëm për të mësuar. Kur befasisht, disave që në fillim, disave në mes, dhe disa të tjerëve ende pa mbaruar studimet u thuhet: Ecni! Përjashta?

A s'është kjo ajo çka ndodh me njerëzit në këtë jetë. Disa lindin të vdekur, disa sapo caktojnë në kokën e tyre qëllimin e jetës befasohen nga vdekja, e ndërkohë askush nuk del nga kjo jetë me qëllime, ëndrra dhe ambicie të realizuara.

E pra nëse ti je krijuar që të jetosh për një qëllim të caktuar, atëherë **së pari** duhet që pa stërmundime dhe krejt natyrshëm ta jetosh këtë qëllim përgjatë gjithë jetës tënde dhe **së dyti** duhet të jesh i përjetshëm në këtë dynja, ashtu që të përmbushet plotësisht qëllimi përkatës. Nëse ky qëllim është kënaqësia, atëherë duhet që normalisht dhe pa stërmundime të arrishë të përjetosh kënaqësinë përgjatë gjithë jetës tënde dhe krahas kësaj duhet që të vazhdoshë në përjetësi të jesh i kënaqur, sepse vetëm kështu justifikohet qëllimi në fjalë. E kjo gjë vlen të thuhet në lidhje me çdo qëllim tjetër të vetëvendosur. Porse, vjen vdekja. dhe ia çjerr maskën të gjitha këtyre qëllimeve të rreme dhe i bën ata të dështojnë, gjë që tregon qartë se asnjë nga këto qëllime nuk qëndron, dhe se qëllimi i vërtetë është diçka tjetër.

Nëqoftëse do të meditojmë sesi gjenarata jonë njerëzore para disa dhjetëra vitesh nuk ekzistonte, dhe sesi pas maksimumi njëqind vjetësh do të zhduket sërish nga skena "Dynja" e ekzistencës, atëherë do të na hapen sytë e mendjes akoma më tepër në lidhje me sa përmendëm më lart. Në këtë rast mendja e mençur do tentojë t'i përgjigjet pyetjes që del natyrshëm para saj: Ky brez miliardash që vjen në ekzistencë përse vjen? A thua thjesht për t'u zhdukur më pas sërish? Nuk bëhet fjalë për një person apo një komb, por bëhet fjalë për një gjeneratë të tërë njerëzore. Madje jo vetëm për një gjeneratë por për gjenarata të tëra që në të njëjtën trajtë këmbehen në skenën e quajtur "Dynja". Çështja nuk ka të bëjë thjesht me një person të cilit u përpoqëm t'i gjejmë një qëllim për ekzistencën e tij, por ajo ka të bëjë me gjenarata të tëra njerëzore që kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë në këtë jetë derisa të shkatërrohet ky univers. Mirëde, arrite të filozofosh dhe komentosh vërtetësinë e ekzistencës së një njeriu, ndoshta dikush u tregua edhe neglizhent karshi kësaj,

por si të bëjmë për të shpjeguar vërtetësinë dhe domethënien e ekzistencës së brezave të tërë njerëzor që vazhdojnë të këmbehen me njëri-tjetrin. Hyn njëri e del tjetri. Hyn... del... Ky që thotë hyra në këtë jetë me qëllim që të dëfroj, kërcëj etj, përse del nga kjo jetë dhe këmbehet nga njerëz të tjerë.

E pra ai që përgjigjet kaq cekët -hyra të dëfroj etj- në fakt nuk ka kuptuar asgjë nga vërtetësia e jetës dhe realiteti i saj.

A e dini se kujt i përngjan shembulli i të këtillëve? I ngjan një numri të madh personash që janë më të shumtë në numër se sediljet e autobusit në të cilin kanë hipur dhe që mendojnë se qëllimi i gjithë udhëtimit të tyre është që të zënë një vend në këtë autobus. Fillojnë të grinden me njëri-tjetrin duke thënë: Ky vend më takon mua për këtë e atë arsye. Tjetri thotë: Jo, më takon mua... Jo, mua... jo, mua... E ndërkohë që ata nuk rreshtin së zënuri me njëri-tjetrin për vendet e autobusit, shoferi thotë: Zbrisni. Stacioni i fundit...

Afërsisht kjo është historia e neglizhentëve karshi Botës Tjetër. Kur vjen stacioni i fundit, vdekja, i gjen ata duke u grindur për "karriget" e dynjasë... Ata nuk e morën vesh se janë në një udhëtim..., harruan qëllimin e vërtetë të këtij udhëtimi dhe u preokupuan me një gjë krejt tjetër prej së cilës, deshën nuk deshën, u larguan ⁵.

⁵ E kushdo që për të gjetur përgjigjen e pse-së së ekzistencës së tij, për të gjetur udhëzimin nëpër shtigjet e rrugës jetë, e kufizon vështrimin në serialin "Jeta e dynjasë" të filmit "ekzistencë njerëzore", nuk ka për të gjetur tjetër veçse atë që gjetën mosbesimtarët, hezitim, humbje, verbëri dhe pyetje pa përgjigje, tamam ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar për ta në Kuranin Fisnik: *"Ajo që ata (mosbesimtarët) dijnë në lidhje me jetën e kësaj bote, është dije e cekët, e ndaj jetës së përjetshme (ndaj Ahiretit -Botës Tjetër-) ata janë plotësisht të shkujdesur."* Er-Rum (7)

(shënim i përkthyesit)

Pikërisht në lidhje me këtë fakt, Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“A nuk e panë ata (mosbesimtarët) se sa gjenerata para tyre kemi asgjësuar, dhe se ata (gjeneratat e para) nuk u kthyen më tek ato (pasardhëse). E të gjithë të tubuar do të paraqiten tek Ne.” Jasinë (31-32)

Të fshehtën e ekzistencës ku nuk mund të depërtojnë shqisat dhe arsyeja jonë, ne e mësojmë nga profetët të cilëve ua zbuloi këtë të fshehtë Krijuesi ynë dhe i ngarkoi ata me detyrën e përcjelljes së kësaj zbulese hyjnore tek mbarë njerëzimi. Vetëm kështu ne do të dalim nga jeta e përhumbur, e kotë dhe e verbër e mosbesimit, për në jetën e ndriçuar prej udhëzimit hyjnor.

Shembulli ynë njerëzor në këtë dynja është si shembulli i një grupi të madh njerëzish që janë marrë dhe dërguar në një shkretëtirë. Zbriten në të dhe sipas një programi që është vendosur për ta shpërngulen dhe udhëtojnë nga një vend në tjetrin. Në udhëtim e sipër u thuhet: Nisuni!...

Nëse duhet të pyesin se për ku, kush mund t'ua japë atyre përgjigjen? Kë duhet të pyesin? Të pyesin njëri-tjetrin?! Sigurisht që i vetmi që mund t'ua japë atyre një orientim të saktë është ai që i ka sjellë këtu, dhe që e di vazhdimësinë e programit të udhëtimit të tyre nëpër këtë shkretëtirë. Vetëm atë duhet të pyesin...

Ne njerëzit hyjmë në këtë botë, udhëtojmë, transferohemi nga një program në tjetrin, nga një fragment në tjetrin, nga foshnjëria në rini, për në maturi, për në pleqëri, nga dobësia për në energji dhe fuqi, etj etj; dhe në fund na thuhet: Dilni!

Nëse do ta dish se ku, dije se nuk ke vetëm se një rrugë të vetme, nëpërmjet profetëve që i ka dërguar tek njerëzimi Ai që i krijoi njerëzit, Ai që të krijoi ty, Ai që të solli në këtë ekzistencë.

-Vërtetësia e Jetës-

Pikërisht në lidhje me këtë fakt, Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“...Ju ka ardhur nga Allahu dritë dhe Libër Sqarues -Kurani-. Me të Allahu udhëzon për në rrugët e shpëtimit ata që ndjekin kënaqësinë e Tij dhe me lejen e Tij i nxjerr nga errësirat në dritë dhe i udhëzon në rrugë të drejtë.” El-Maideh (15-16)

Nëpërmjet këtij udhëzimi -Kuranit- mësuam nga Krijuesi ynë se Ai ka caktuar që ekzistenca jonë t’i takojë dy botërave.

Tani vëreni me kujdes se cili është qëllimi për të cilin jemi krijuar.

Pra ne na ka ardhur nga Zoti ynë udhëzimi, dhe vetë ecuria e jetës e vërteton këtë udhëzim. Po qe se unë të them se ky këtu është një magnetofon, pastaj incizoj me të dhe ta vë shiritin e incizuar që ta dëgjosh, pas kësaj ti sigurisht që do të bindesh për vërtetësinë e fjalëve të mia. Vërtetim me vepra.

Po kështu, kur Allahu i Lartësuar na lajmëron për të vërtetën e çështjes njerëzore dhe pastaj e shohim realitetin të përputhet plotësisht me këtë të vërtetë, atëherë ne e kuptojmë pa mëdyshje saktësinë e lajmit hyjnor.

Ne mësuam nga udhëzimi hyjnor se Krijuesi ynë ka caktuar që ekzistenca jonë ti takojë dy botërave, pra se Krijuesi ynë e ka ndarë jetën tonë në dy etapa:

Në jetën e kësaj bote – që është bota e provimit në të cilën Zoti ynë na provon në ato gjëra që na ka lënë në përgjegjësi.

Në jetën e Botës Tjetër – që është bota e shpërblimit.

Kurse vdekja s’bën gjë tjetër veçse e transferon njeriun nga bota e provimit për në botën e shpërblimit.

Krejt e qartë. Vetëm kështu mund të komentohet kuptueshëm vërtetësia e jetës sonë. Përse hymë në këtë

jetë? Përgjigjja, për t'u sprovuar. Dalim nga kjo jetë përse? Përgjigjja, për t'u gjykuar dhe shpërblyer.

Bashkë me ty në këtë jetë ka mbretër, ministra, qeveritarë, eprorë, vartës, të pasur, të varfër, të mëdhenj, të vegjël, brezat, kombet e njëpasnjëshëm... e përgjigjja për vërtetësinë dhe pse-në e ekzistencës së gjithë këtyre ëshë një:

Kjo botë për të gjithë është bota e provimit. Pastaj, përse këta të gjithë, bashkë me ty, dalin nga kjo jetë? Përgjigjja, sepse mbaron provimi. Ku shkojmë? Përgjigjja, për në botën e gjykimit dhe shpërblimit.

5 - Kjo botë është bota ku provohemi për sa na është lënë në përgjegjësi.

Tani do të sjellim përgjigjen e pse-së së ekzistencës sonë dhe do të argumentojmë faktin se gjendemi në një botë prove.

Nëse vërejmë pozicionin e njeriut mbi këtë tokë, do ta gjejmë atë në pozicionin e një trashëgimtari të përgjegjësuar. Ai që e ka vendosur njeriun në këtë pozicion është vetë Sunduesi i tokës, Allahu i Lartësuar.

Le ta vërejmë pak më me imtësi këtë pozicionim të njeriut në këtë dynja, mbi shpinën e tokës, dhe të shohim së bashku argumentet që vërtetojnë bindshëm qenien e kësaj bote një botë prove.

Argumenti i parë, është vetë fakti se njeriu në këtë tokë është në pozicionin e një trashëgimtari të cilit ky prestigj i është mundësuar dhe nuk e ka fituar vetë.

Do t'i gjesh kafshët të nënshtruara për interesin dhe dobinë tënde o njeri. Po kështu edhe pemët, ujin, ajrin... aq sa njeriu u vetëquajt padroni i natyrës.

Por në të vërtetë, kur shikon realitetin dhe pyet vetveten se, a ti o njeri e ke krijuar pemën, ujin, ajrin...? A ke krijuar ti o njeri gjë prej gjëje në vetveten tënde? Përgjigjja vjen krejt natyrshëm, "jo". E pra, e vërteta e parë që gjejmë, është fakti se njeriu vetëm në sajë të dëshirës së Krijuesit dhe Sunduesit të universit, është mundësuar që të jetë në këtë pozicion që është në këtë botë. A ka dyshim në këtë fakt?! A mundet njeriu të pretendojë se ka krijuar ndonjë nga krijesat? A gjendet

ndokush që të mohojë se njeriut i janë nënshtruar mbarë ligjësitë dhe i gjithë universi me gjithçka në të?

☪ Nuk ishte ti, o njeri që i bëre të tilla këto ligjësi dhe krijesa, porse në fakt ti kur erdhe në këtë ekzistencë i gjete ata të tilla, të nënshtruara në interesin dhe dobinë tënde.

☪ Kështu pra, e vërteta e parë me të cilën përballlet njeriu është fakti se ai në këtë botë është përgjegjësuar dhe është bërë trashëgimtar i gjërave që nuk janë të tijat...

☪ Allahu i Lartësuar në lidhje me këtë fakt thotë në Kuranin Fisnik:

☪ **“-Allahu- është Ai që krijoi për ju gjithçka ka në tokë...”** El-Bekare (29)

☪ Dhe thotë:

“Allahu është Ai që bëri për ju natën që të pushoni në të, dhe ditën të ndritshme. Allahu është Dhurues karshi njerëzve, porse shumica e njerëzve nuk falenderojnë. Ky është Allahu, Zoti juaj, Krijuesi i çdo gjëje, nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij, e si lëkundenit?” Gafir (60-61)

☪ Dhe thotë: **“Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai mbi çdo gjë është Mbikqyrës.”** Ez-Zumer (62)

☪ Po po. Allahu është Krijuesi i çdo gjëje. Ai solli në ekzistencë çdo gjë.

☪ Njeriu nuk ka të tijën asgjë nga vetvetja e tij, madje as zemrën e tij që dihet mirë se rreh në mënyrë të pavullnetshme dhe të pakontrolluar nga njeriu, aq sa edhe kur njeriu flenë gjumë dhe ka humbur arsyen, zemra e tij vazhdon të rrah papushim.

☪ Njeriu nuk posedon nga vetvetja e tij as dorë, as gjuhë, as sy, as këmbë, as lëkurë, as kockë, as mish, as nerv, as kapilar gjaku, e madje asnjë qime floku apo pikë gjaku; sepse njeriu nuk ka krijuar asgjë nga vetvetja e tij.

☪ Allahu i Lartësuar në lidhje me këtë çështje thotë në Kuranin Fisnik:

“Ne ju kemi krijuar, përse nuk e pranoni (ringjalljen)? A më tregoni për farën (njerëzore) që derdhni, a ju apo Ne jemi Krijuesit e saj?!” El-Uakia (57-59)

Dhe thotë: *“O ju njerëz! Adhurojeni Zotin tuaj që ju krijoi juve dhe ata që ishin para jush, që të jeni të devotshëm.”* El-Bekare (21)

Kështu pra, konkluzioni është mëse i qartë dhe nuk ka nevojë fare për debat. Të gjithë argumentet dëshmojnë se njeriu është i krijuar, dhe se gjithçka ka në tokë dhe në mbarë universin prej ligjeve dhe krijesave janë të krijuara dhe nënshtruara në interes dhe dobi të njeriut.

Atëherë përsërisim: Cili është qëllimi i kësaj jete? Cila është pse-ja e ekzistencës?

Fillimisht kuptuam se Krijuesi i dha këtij njeriu gjëra që nuk janë të tijat por janë të Krijuesit, që njeriu t'i përdorë këto gjëra dhe të përfitojë prej tyre. **Ky është rezultati i parë.**

Kalojmë tek rezultati tjetër.

Duke qenë se njeriu nuk ka të tijën asgjë në këtë botë, as nga vetja e tij dhe as nga gjërat që e rrethojnë, atëherë kuptohet qartë se ai është në rolin e të përgjegjësuarit të cilit i është dhënë një lloj pushteti i përkohshëm në pronën e tjetërkujt. I janë dhënë atij aftësi dhe mundësi që e lejojnë të shfytëzojë në dobi dhe interes të tij çfarë ka në tokë.

Pikërisht në lidhje me këtë fakt, Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“A nuk keni parë se Allahu ka nënshtruar për të mirën tuaj gjithçka ka në tokë... S’ka dyshim se Allahu është Mirëbërës, Mëshirues ndaj njerëzve.”

El-Haxh (65)

Dhe thotë: *“A nuk e dini se Allahu nënshtroi për të mirën tuaj çka në qiej e çka në tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshme e të fshehta. E megjithatë prej njerëzve ka që polemizojnë në lidhje me çështjen e Allahut...”* Lukman (20)

Së treti: Disa njerëz e emërtuan njeriun me titullin prestigjioz “padroni i tokës”. Dihet qartë se ky prestigj që i është dhënë njeriut ndër gjithë krijesat u bë i mundur vetëm si pasojë e aftësive dhe dhuntive të veçanta me të cilat e pajisi njeriun Krijuesi i tij.

Një tjetër gjë që e bëri të mundur këtë epërsi prestigjioze të njeriut në rang krijesash është edhe prania e ligjësive tokësore dhe më gjerë që janë krijuar në një formë të tillë që t’i sjellin dobi të drejtpërdrejtë njeriut, si dhe të mund të shfrytëzohen prej tij.

Por gjithçka përmendëm më lart nuk do të kishte pasur aspak vlerë nëse Krijuesi nuk do ta kishte favorizuar njeriun duke mos krijuar në tokë apo diku gjetkë një krijesë tjetër inteligjente agresive, të tillë që të qëndronte më lartë se njeriu dhe të arrinte të vinte pushtetin e saj mbi të.

Sa përmendëm është me shumë rëndësi. Ajo mund të përmbliidhet me një fjalë të vetme. Nënshttrim për njeriun... Pa këtë, njeriu nuk do të ishte ky që është ..

Një dijetar musliman thotë: Meditoni nëse Allahu i Lartësuar do ta kishte krijuar mushkonjën në madhësinë e një elefanti.

Që kjo gjë të bëhej realitet nuk ka asnjë pengesë, duke ditur se origjina e elefantit ashtu si edhe ajo e mushkonjës është zigota -qeliza mikroskopike e plenuar- që tek të dy këta ka strukturë dhe madhësi pothuajse të njëjtë. Ndërsa vetëm pas fazës së zhvillimit embrional të mëtejshëm të zigotës nga njëra del elefanti gjigand dhe nga tjetra del mushkonja e vogël. Përse trupi i mushkonjës nuk rritet dhe zhvillohet më tej ashtu si ai i elefantit?!

Imagjinoni sikur mushkonja të rritej në madhësinë e elefantit dhe të fluturonte drejt zonave të populluara... A do të ngelej më njeri i gjallë?! Të të pickonte dhe thithte gjakun një mushkonjë kaq e madhe?! Atëherë sigurisht që rrallë njeri do mund të ngelej në këtë ekzistencë...

Pra toka dhe krijesat e saj janë sistemuar dhe përsosur për dobinë dhe interesin tënd o njeri, dhe ti je mundësuar të jesh i parë në të...

Dëgjoni një tjetër shembull prej shembujve të shumtë që nxjerrin në pah sesi Krijuesi i nënshtroi në interesin e njeriut shumë krijesa në tokë.

Deveja apo elefanti, që të dy gjigand, dhe në krahun tjetër macja e vogël. Devenë apo elefantin gjigand e tërheq pas vetes një fëmijë i vogël, e ulë atë përtokë, ngarkon mbi të çfarë do, hipën edhe vetë sipër saj dhe e dërgon ku do.

Në krahun tjetër macja e vogël... Merre zbutësin më të madh të kafshëve dhe urdhëroje që t'i vendosë ndonjë maceje një jastëk e sipër tij ndonjë kilogram çfarëdo dhe shiko se çdo të ndodhë.

Një gjë e tillë me macen është e pamundur. Përse ndodh kështu? Përgjigjja është tepër e thjeshtë: Sepse deveja dhe elefanti janë krijuar të nënshtroara për neve në këtë drejtim, kurse macja jo.

Kush i nënshtroi për ty kafshët e ndryshme prej të cilave t'i përfiton pa masë? Padyshim se Ky është Krijuesi që këto lloje të kafshëve i krijoi të tilla sepse kështu deshi...

E pra është Allahu i Lartësuar Ai që e nënshtroi në dobinë tënde tërë universin dhe gjithashtu nuk krijoi në të ndonjë krijesë që të të konkuronte dhe sfidonte ty.

Kështu pra o njeri!

Është vullneti i Zotit tënd ai që vendosi që ti të bëhesh trashëgimtar në tokë dhe sundues i saj.

... Porse prapë se prapë o njeri ti përsëri mbetesh rob krejt i nënshtruar i Atij që mundësoi për ty gjithë sa përmendëm.

... A nuk janë faktet që përmendëm deri tani krejt të qarta dhe transparente?!

... Pra për nga ana e prestigjit dhe pozicionit në tokë, njeriu është krejt si një mbret, porse realiteti qëndron se ky mbret nuk ka të tijën në këtë tokë asgjë. A jemi dakort me këtë?

... Pra a është njeriu në tokë në rolin e padronit absolut? Përgjigjja: Jo. Ti o njeri nuk ke krijuar asgjë as në këtë tokë dhe as në vetveten tënde, dhe nuk sundon sipas dëshirës e në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtpërdrejtë asgjë prej gjëje.

... Ky është realiteti. Prej këtui, njeriu mëson se në këtë tokë është në pozicionin e atij që nga Sundimtari i Vërtetë i saj dhe mbarë universit, është mundësuar të jetë trashëgimtar dhe sundimtar i përkohshëm, i privuar dhe joabsolut.

... Në lidhje me këtë fakt, Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: “...*Unë -Krijuesi- do të bëj në tokë një mëkëmbës ...*” El-Bekare (30)

... Dhe thotë: “...*dhe ju bëri juve (o njerëz) mbizotërues të tokës. E pra, a ka zot tjetër përveç Allahut?! Jo, mirëpo ju e përkujtoni shumë pak këtë.*”

En-Neml (62)

... Dhe thotë: “...*t’ju bëjë ju mëkëmbës në tokë, e t’ju shikojë se si do veproni.*” El-Earaf (129)

... Dhe thotë: “*Është Ai -Allahu- që ju bëri ju sundues në tokë. Disa prej jush i ngriti në grada më të larta, e kjo me qëllim që t’ju provojë në lidhje me sa ju dha. S’ka dyshim se Zoti yt (o njeri) është Gjykues i shpejtë dhe se Ai është Falës dhe Mëshirues (për ata që pendohen).*” El-Enam (165)

Njeriu vërtetë gjendet në fronin e trashëgimitarit dhe sunduesit, porse ai nuk sundon përveçse atë që deshi t'ia nënshtronte Sunduesi i Vërtetë i universit.

Kështu, nuk është njeriu ai që zgjodhi kohën apo vendlindjen e tij, as prindërit e tij, as gjininë e tij, as ngjyrën, gjuhën, racën apo kombin e tij, as dhuntitë fizike dhe shpirtërore të tij, as planetin apo universin ku jeton dhe as ligjësitë e tij, as strukturën trupore të tij, as diellin, as hënën, as ujin, as ajrin, as dheun... as jetën dhe as vdekjen e tij, gjëra këto që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën dhe forcën e trashëgimisë, mëkëmbjes dhe sundimit të njeriut në këtë tokë.

Gjithashtu Sunduesi i Vërtetë, kur të dojë, ia merr prapë njeriut fronin e trashëgimisë. E shohim njeriun sesi ai del nga kjo jetë dhe dorëzon të gjitha gjërat që iu lanë përkohësisht atij në përgjegjësi.

Pra ti o njeri je një trashëgimtar, por sundon çfarë? Sundon çfarë ka dashur Ai që të mundësoi ty të jesh sundimtar i përkohshëm në tokë. Atë çfarë ka dashur Sunduesi i Vërtetë dhe jo çfarë ke dashur ti o njeri. Ai zgjodhi për ty intelektin tënd, pamjen dhe fizionominë tënde, racën dhe gjininë tënde, prindin tënd, epokën tënde, atdheun tënd, paraardhësit dhe pasardhësit e tu, botën që të rrethon...

Ti o njeri je sundimtar në ato rrethana dhe kritere që ka caktuar për ty Sunduesi i Vërtetë i universit. Ai është Sunduesi i Vërtetë, kurse ti je i përgjegjësuar dhe prestigjuari prej Tij.

Kjo gjë është krejt e qartë. Vetë mendja e njeriut, nisur nga faktet e jetës, dëshmon pa hezitim se njeriu është krijesa e prestigjuar nga Sunduesi i Vërtetë për të qenë sundimtar dhe trashëgimtar në këtë tokë, por vetëm i asaj çfarë ka dashur Sunduesi i Vërtetë, Allahu i Lartësuar.

Mirë... Çfarë mbeti tjetër?

Mbeti e vërteta tjetër. Bjeri! Dorëzoi!... Rikthimi!... Dorëzimi!... Kthimi i amaneteve...

Neve njerëzit fillimisht ishim të lirë, sundimtarë krenarë e të qetë, porse befasisht vjen vdekja dhe detyrohemi të dorëzojmë gjithçka na u dha... Dorëzoi! Po çfarë të dorëzojë? Dorëzoje pasurinë, paratë! Dorëzoje postin, famën! Dorëzoje pushtetin! Dorëzoje syrin tënd, të parin! Dorëzoje të dëgjuarin tënd, veshin! Dorëzoje trupin tënd, rininë, bukurinë, forcën tënde! Dorëzo çdo gjë! Dorëzoje jetën!

Gjë e habitshme. Një krijese, vetë Krijuesi i saj ia dha mundësinë të bëhet sundimtare në tokë, i dha kaq shumë gjëra për një periudhë të pacaktuar kohe, pastaj i tha dorëzoji, riktheji, dhe ia mori gjithçka i dha?!

Pikërisht në lidhje me këtë gjë Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“Në të vërtetë ju (o njerëz) na erdhët (në Botën Tjetër) një nga një (të vetmuar), ashtu siç ju krijuam herën e parë, dhe latë pas shpine atë çfarë u patëm dhënë...” El-Enam (94)

A s'është ky realiteti?! Ku është Faraoni? Ku janë mbretërit e tokës? Ku është Hitleri? Diktatorët e tjerë ku janë? Ku janë shumë e shumë prej miliarderëve? Ku janë personazhet që regjistroi historia në shekullin e kaluar? Po në shekujt para tij? Nesër pyetja do të jetë: Ku shkuam dhe ku do të jemi të gjithë ne?...

Krijuesi, i dha njeriut, i mundësoi dhe më pas ia mori prapë dhe nuk i la gjë prej gjëje.

Çudi! Mirë... Njëri të thotë ty: Merri! Merri! Mbaji... Merri! Merri!... Pastaj, befasisht, pas ca kohësh të thotë: Nëmi! Mi jep! Jepmi!... E së fundi: Hajde dil nga kjo jetë!

Atëherë përse t'i dha? A mos qëllimi ishte që të t'i pronsonte ty, t'i bënte pronë tënden të patundshme?

Përgjigjja: Nëse do të ishte ky qëllimi, atëherë nuk kishte pse të t'i merrte prapë. **Apo mos qëllimi i kësaj dhënie ka qenë thjesht që të t'i rrëmbente prapë?**

Nëse do të ishte ky qëllimi atëherë s'kishte pse të m'i jepte këto mirësi qysh në fillim, qysh kur s'kisha asgjë. Pastaj, një Fisniku që di të bëjë të tilla dhurata të pashlyeshme nuk i shkon për shtat kurrsesi cilësia e rrëmbimit dhe as e ekspozimit të forcës.

Atëherë, t'i dha këto gjëra dhe mundësi por qëllimi nuk ishte që ato të bëheshin prona jote. T'i merr e nuk është qëllimi i kësaj marrje rrëmbimi, përderisa Ai t'i dha këto gjëra me dëshirën e Tij. E pra kush është në realitet qëllimi?

Dëgjoje përgjigjen! Qëllimi është provimi. T'i dha që të të provojë dhe shohë se si do të veprosh me to. Vetëm kaq? Po, vetëm kaq.

Çështja është më e thjeshtë se filozofitë e çmendura që kanë nxjerrë sa e sa prej filozofëve të shfrenuar...

T'i dha këto gjëra jo me qëllim që ato të bëhen pronë e jotja e patundshme dhe kjo kuptohet qartë nisur nga vetë fakti se Ai t'i mori prapë gjërat që t'i dha; e t'i mori sërish por jo me qëllim që të t'i rrëmbejë dhe kaq, sepse ishte vetë Ai që t'i dha ato gjëra fillimisht me dëshirën e Tij.

Atëherë ku qëndron e vërteta dhe cili është qëllimi? Qëllimi o njeri është që të të provojë se çfarë do të bësh e si do të punosh, "*...t'ju bëjë mëkëmbës në tokë e t'ju shikojë se si do veproni.*" El-Earaf (129)

Që t'ju shikojë se si do veproni.

Kjo afërsisht -e për Allahun është shembulli më i lartë-siç i fut një përgjegjës disa kandidatë për t'u punësuar në një ofiçinë. U thotë: Merrni çfarë vegle të doni. Dhe i lë të lirë të punojnë.

... E shikon ndonjërin që mund të veprojë gabim, por nuk e trazon. Nuk ndërhyt por e lë të lirë...

... Koha kalon kur ja, befas, dëgjohet një zë: Dilni! Dorëzoni çfarë ju dhashë! Po ti vetë na i dhe. E tani po na i merrë prapë?! Thotë: Sigurisht që po!... Po pse?!

... S'mund të ketë tjetër koment për këtë gjë, përveçse se ky është një provim.

Ashtu si në sallën e provimit ku nxënësve u shpërndahen mjetet e punës, lihen të lirë dhe në fund u merret çdo gjë që iu dha... Përse? Sepse ky është një provim.

Kështu edhe ti o njeri në këtë botë. Je në një provim ku Zoti yt të shikon se çfarë do të bësh dhe si do të punosh. Kjo është jeta dhe ky është qëllimi i vërtetë i saj. Po po. Një provim.

Dhe vetë ecuria e jetës është dëshmitare dhe komentuese për shpjegimin që na jep Kurani, fjala e Allahut të Lartësuar, në lidhje me realitetin dhe vërtetësinë e kësaj jete dhe me faktin se kjo jetë s'është veçse një provim.

Krijuesi yt të provon me shëndet apo sëmundje, me pasuri apo varfëri, me dituri apo padituri, me forcë apo dobësi, të provon në marrëdhëniet e tua me të afërmit e tu, shokët e tu dhe njerëzit mbarë, në ndjenjat dhe dëshirat e tua se si i edukon dhe ushqen ato, të provon në çdo gjë që të dha dhe bën që për këtë provim të ketë edhe rezultate.

Pra përderisa ka provim, patjetër që ka edhe rezultate.

Por ku janë rezultatet?... Hajde, dilni nga salla e provimit "dynja" të shihni rezultatet.

Ky është qëllimi i vdekjes, që të boshatisë dhe bëjë gati sallën e provimit "dynja" për të tjera gjenerata dhe që personat që mbarojnë "provimin dynja" t'i transferojë nga kjo botë për në botën e shpërblimit ku do të takojnë rezultatet e asaj ç'ka punuan.

-Vërtetësia e Jetës-

A nuk është gjithçka thamë prej të vërtetave të prera?!

Pikërisht kjo është edhe ideja që jep Kurani Fisnik, fjala e Allahut të Lartësuar, se:

Njeriu është një rob i Zotit të cilin Zoti i tij dhe i gjithë universit e përgjegjësoi dhe bëri trashëgimtar në tokë për ta parë se si do të veprojë kundrejt orientimeve hyjnore.

6 - Çfarë nënkupton thënia se kjo dynja është bota e sprovës?

Allahu i Lartësuar e mundësoi njeriun që të jetë trashëgimtar në tokë për një kohë të afatizuar të cilën vetëm Allahu e di, me qëllim që të shohë nëse njeriu, robi i Tij, do t'u bindet apo do t'i kundërshtoj urdhërat e Tij të shpallura nëpërmjet librave dhe profetëve të Vet.

Në këtë formë Allahu i Lartësuar dallon besimtarin nga mosbesimtari, të bindurin nga i pabinduri, mirënjohësin nga mosmirënjohësi, dhe në Ditën e Gjykimit secilin e shpërblen në bazë të asaj çfarë bëri me të mirat që i dha i Madhi Zot.

Çdo njeri është në provë se si do të veprojë me mirësitë që i dha Allahu i Lartësuar. A do t'i përdorë ato në përputhje me orientimet hyjnore apo jo?

Ky në fakt është edhe kuptimi i adhurimit, sepse adhurimi nuk është gjë tjetër veçse bindja dhe nënshtrimi karshi orientimeve hyjnore dhe të jetuarit nën udhëheqjen e këtyre orientimeve të ndritura.

Nisur nga sa thamë më lart del qartë në pah kuptimi i thënies Kuranore në të cilën Allahu i Lartësuar thotë: *“Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit përveçse që ata të më adhurojnë Mua. Nuk dua prej tyre ndonjë shpërblim dhe as dua që të më ushqejnë. Në të vërtetë Ai, Allahu, është Furnizuesi, i Forti, i Fuqishmi.”*

Edh-Dheriat (56-58)

Kështu pra, deri tani folëm në lidhje me qëllimin për të cilin është krijuar njeriu dhe thamë se ky qëllim është i pakonceptueshëm nga logjika njerëzore, nisur nga vetë fakti se njeriu që jeton, shikon dhe njeh vetëm një etapë -jetën e kësaj bote- prej etapave të ekzistencës së tij, nuk ka sesi ta dijë qëllimin apo pse-në e ekzistencës njerëzore, ekzistencë e cila kalon nëpër shumë etapa të tjera krahas etapës së kësaj bote.

Siç dihet mirë, gjithkush që kufizohet në një prej shumë etapave nëpër të cilat kalon diçka, sado që të mendonjë dhe meditojë, nuk do mund ta kuptojë kurrësi qëllimin e vërtetë të kësaj diçkaje vetëm se pasi t'i shikojë dhe marrë në konsideratë të gjitha etapat nëpër të cilat ajo kalon.

Ashtu siç e përmendëm edhe më lart faktin se një person që nuk ka asnjëfarë njohurie në lidhje me fabrikat e prodhimit të disa makinerive të tipeve të caktuara, sado i ditur që të jetë, nëse mundësohet të shikojë në një prej reparteve të fabrikave në fjalë vetëm një fazë prej fazave nëpër të cilat kalon prodhimi i një makinerie çfarëdo -për shembull faza e prodhimit të pjesëve të skeletit të jashtëm të makinerisë ose ndonjë fazë tjetër-, ai nuk do të arrijë ta kuptojë qëllimin e vërtetë të prodhimit të kësaj makinerie, dhe nuk do të arrijë të gjykojë me siguri nëse kjo makineri kryen këtë apo atë funksion dhe shërben për këtë apo atë qëllim në bujqësi, industri, shkencë, ujë, tokë, ajër..., përveçse nëse mundësohet të shikojë deri në fund të gjitha fazat nëpër të cilat kalon prodhimi i kësaj makinerie.

Duke qenë se ekzistenca e qenies njerëzore kalon nëpër shumë faza; ajo e barkut të nënës së cilës i përket faza embrionale e zigotës -qelizës mëmë-, faza e fetusit embrional të varur në mitër -fazë në të cilën qeliza mëmë shndërrohet nga një pikëz uji e ngjizur në një masiv gjaku të mpiksuar që i përngjan shushunjëzës- dhe më pas fazat e

tjera të njëpasnjëshme deri në fazën embrionale përfundimtare në të cilën Krijuesi i Gjithëdijshtëm mundëson që njeriu të marrë trajtën e plotë të krijesës njerëzore; për t'u ekspozuar më pas përpara një tjetër faze që e pret atë por tashmë jashtë barkut të nënës, në ligjësitë e dynjasë në të cilën qenia njerëzore kalon në shumë nënfaza, kalon nga faza e foshnjërisë në atë të fëmijërisë, nga ajo e fëmijërisë në atë të adoleshencës, nga ajo e adoleshencës në atë të rinisë, nga ajo e rinisë në atë të maturisë, nga ajo e maturisë në atë të pleqërisë; e kështu me rradhë derisa në një nga këto nënfaza vjen faza e vdekjes së trupit të njeriut; kurse para gjithë kësaj ishte faza në të cilën njeriu jetonte i shpërndarë në dejet e të parëve të tij, në botën e kromozomeve dhe gjeneve, brenda qelizave të të parëve që u formuan në trupin e të parëve tanë nëpërmjet ushqimit që ata e morën nga dhëu i tokës; lind pyetja, çfarë, çfarë do të bëhet me ecurinë ekzistenciale të qenies njerëzore pas fazës së vdekjes së trupit material?

... A mund ta kuptojmë qëllimin e ekzistencës sonë duke u bazuar vetëm në këto faza zinxhir nëpër të cilat kaluam, derisa arritëm tek faza e vdekjes?

... A është e drejtë të themi se me fazën e vdekjes mbaron çdo gjë?

... S'ka dyshim se ai që e ngurtëson mendimin e tij -në lidhje me kuptimin e qëllimit të ekzistencën njerëzore- vetëm në fazat e dynjasë, nuk ka sesi të arrijë në ndonjë rezultat, dhe një njeri i tillë po që se do të mundohet të flasë për pse-në e ekzistencës së njeriut, nuk ka dyshim se do të flasë në tym sado i ditur që të jetë...

Imagjinoni një krijesë inteligjente që nuk di asgjë në lidhje me etapat krijuese nëpër të cilat kalon qenia njerëzore.

I mundësohet të shikojë vetëm tek faza embrionale e fetusit nëpër të cilën kalon ekzistenca e njeriut. Shikon të krijohen tek njeriu në këtë fazë përsomërisht dhe në mënyrë krejt të mahnitëshme dy sy, duar, këmbë, aparati i frymëmarrjes, i tretjes, etj, shqisa dhe organe këto që njeriut në këtë fazë ekzistenciale të tij nuk kanë ç' i duhen aty brenda barkut të nënës...

Kjo krijesë, sado inteligjente qoftë, çfarë konkluzioni do mund të nxjerrë për ekzistencën e qenies njerëzore, duke u ngurtësuar vetëm në këtë fazë dhe duke mos i hedhur sytë e mendjes diku përtej kësaj faze...

Ky është edhe sekreti i injorancës në të cilën ka rënë një pjesë e mirë e njerëzisë në lidhje me vërtetësinë dhe pse-në e saktë për të cilën u krijua dhe jeton qenia njerëzore në fazën "jetë e kësaj bote".

Dhe kanë rënë në këtë injorancë sepse siç thamë më lart, qëllimi i ekzistencës njerëzore mund të dalë në pah vetëm duke e përgjithësuar vëzhgimin tonë tek të gjitha fazat ekzistenciale të njeriut dhe duke mos u kufizuar tek disa prej këtyre fazave dhe ç' është më e rëndësishmja duke mos neglizhuar asnjë prej tyre.

Nisur nga shkakun në fjalë vërejtëm sesi perëndimorët kur e lanë mënjanë fenë e tyre, pasi panë se ajo përplasej me shkencën dhe parimet kyçe të drejtësisë dhe logjikës, dhe kur menduan se njeriu nuk ka nevojë që për të gjetur pse-në e ekzistencës së tij të udhëzohet nga mesazhi hyjnor porse për këtë mendja dhe dituria e njeriut mjaftojnë, atëherë e privuan vetveten nga njohja e qëllimit të vërtetë të ekzistencës së njeriut.

Duke qenë se e ngushtuan vështrimin në lidhje me kuptimin e qëllimit të krijimit vetëm në fazën e jetës së kësaj bote, ranë në injorancë dhe të diktuar nga kjo injorancë nxorrën filozofinë e tyre të gabuar se për ekzistencën e njeriut në këtë jetë nuk ka ndonjë qëllim. Përse?

Sepse logjika njerëzore nuk mund të konceptojë ndonjë qëllim për ekzistencën e njeriut përveçse po që se merr në konsideratë të gjitha fazat nëpër të cilat kalon ekzistenca e tij.

Ateistët dritëshkurtër mohuan që për ekzistencën njerëzore të ketë ndonjë qëllim, porse jeta e njeriut nuk mund të ketë kuptim nëse njeriu nuk ka një qëllim në vetvete, sepse njeriu është krijuar me një natyrë të tillë që të rendë pas përmbushjes së synimeve dhe objektivave të caktuara.

Përderisa njeriu nuk mund të jetojë përveçse duke pasur objektiva dhe qëllime në jetë, atëherë nuk ka dyshim që konkluzioni se jeta e njeriut është e paqëllimtë nuk është i drejtë.

Duke qenë se këta njerëz të cekët mohuan parimin që do t'i çonte tek zbulimi i qëllimit të vërtetë, u detyruan që nga mendjet e tyre të ngushta t'i sajnin qëllime të ndryshme ekzistencës së tyre.

Prandaj, ti o njeri që do t'i sajosh një qëllim ekzistencës së njeriut në këtë botë, dije se çështja e qëllimit të krijimit të njeriut ka mbaruar dhe është vendosur qysh para se të krijohet njeriu, dhe dije se krijimi i njeriut erdhi në përputhje të plotë me këtë qëllim e ty s'të ngelet veçse t'i bindesh këtij qëllimi dhe jo të shpikësh a sajosh qëllime të tjera.

Pra rruga për të marrë njohurinë e saktë në lidhje me pse-në e vërtetë të qëllimit të ekzistencës njerëzore u ndërpre tek ateistët mendjengushtë sepse ata e refuzuan mesazhin hyjnor, dhe siç dihet mesazhi hyjnor është i vetmi që mund të na mësojë saktësisht se cili është qëllimi i vërtetë i ekzistencës së qenies njerëzore.

Krijuesi që na krijoi na dërgoi neve nëpërmjet profetëve mesazhin e Tij hyjnor në të cilin na tregon se përse na krijoi...

Kur debatuar me këta ateistë dhe u sqaruar faktin se nuk ka pjesë prej pjesëve përbërëse të trupit të njeriut që të mos ketë një qëllim, rol apo funksion të caktuar në trup, dhe se të gjitha këto pjesë funksionojnë për llogari të tërësisë së qenies njerëzore, pasi asnjë pjesë prej këtyre pjesëve nuk do të kishte vlerë nëse do të veçohej nga tërësia e trupit, ata e pranuan gjithçka u thamë, dhe arritën ta kuptojnë injorancën që shpreh thënia e tyre se tërësia njerëzore -njeriu- është një ekzistencë e paqëllimtë.

Vetë mendja dhe realiteti dëshmojnë bindshëm se njeriu është krijuar për një qëllim, porse nisur nga fakti se ky qëllim ka lidhje me të gjitha fazat nëpër të cilat do të kalojë qenia njerëzore -e fundit prej të cilave, faza e vdekjes ka ngelur një mister-, njeriu, sado i mençur qoftë ai, nuk mund të arrijë ta zbulojë misterin në lidhje me ekzistencën e tij, përveçse nëpërmjet një rruge të vetme.

Kjo rrugë është duke e mësuar përgjigjen rreth këtij misteri nga vetë Krijuesi që e krijoi ekzistencën njerëzore të tillë që të kalojë nëpër faza.

Vetëm Ai që na krijoi në njerëzve krijesa të tilla që ekzistenca jonë të kalojë nëpër faza, dhe që së fundi me vdekjen e trupit material e transferon ekzistencën njerëzore në një tjetër fazë misterioze për ne njerëzit e gjallë, vetëm

Ky Krijues e di se cili është finalizimi i qëllimit të ekzistencës njerëzore.

Kur kërkuam përgjigje rreth misterit të ekzistencës njerëzore duke u referuar tek mesazhi hyjnor, atëherë gjetëm se qëllimi final i qenies njerëzore është shpërblimi ose ndëshkimi i tij pas vdekjes, në Botën Tjetër, dhe gjetëm se vdekja s'është gjë tjetër veçse një ligjësi që e transferon njeriun nga bota e provimit -bota e përkohëshme- për në botën e shpërblimit -botën e amshueshme-.

Ky fakt përkrahet bindshëm nga logjika e shëndoshë, e papërlyer dhe e pacënuar.

Mesazhi Hyjnor Islam përgjigjet natyrshëm se njerëzit erdhën në këtë dynja të përkohëshme me qëllim që të provohen në lidhje me sa do punojnë, dhe vdesin me qëllim që të kurorëzohet provimi i tyre në këtë dynja e të shpërblehen për të korrur atë që mbollën.

Kur shikojmë rrjedhën e jetës dhe realitetin e saj e gjejmë atë dëshmitare dhe përkrahëse për atë çfarë na ka lajmëruar Allahu i Lartësuar nëpërmjet Mesazhit Hyjnor Islam.

Kurse qëllimet e shpikura dhe fallso demaskohen dhe asgjësohen me vdekjen, duke qenë se ato janë të ngurtësuara vetëm me këtë dynja që s'është veçse një fazë e shkurtër prej fazave nëpër të cilat kalon ekzistenca njerëzore.

Me pyetjen sfiduese **“Përse vdes?”** hidhen poshtë të gjitha qëllimet e sajuara gabimisht për ekzistencën njerëzore, sepse është vdekja ajo që u jep goditjen këtyre qëllimeve të ngushta, dritëshkurtra, të fantazuara dhe të ngritura duke u bazuar vetëm në serinë **“Dynja”** të serialit **“ekzistencë njerëzore”**.

Realiteti është se njeriu nuk ka krijuar asgjë nga kjo ekzistencë, asnjë pikë gjaku apo qelizë në trupin e tij, asnjë elektron apo thërmijë të vetme në qiell apo në tokë, asnjë fije bari, asnjë bulëz uji, asgjë, porse sa çudi, e gjejmë atë që në shumë gjëra të ekzistencës, që s'janë pronë e tij -me argument se njeriu nga një moment në tjetrin mund t'i lerë pas-, të veprojë si të jetë sundimtari apo padroni legjitim i tyre.

Gjë e çuditshme! Njeriu s'ka krijuar gjë prej gjëje dhe krijimi dhe ligjësia e tyre nuk kanë të bëjnë fare me vullnetin e tij. Nga një moment në tjetrin, kundra dëshirës së tij, mund t'i lerë pas këto gjëra.

Porse krahas kësaj, fakti se ky njeri është mundësuar që të jetë në fronin e padronit është një fakt i pamohueshëm...

Lind pyetja: Cili është argumenti se njeriu ka ardhur në këtë dynja që të provohet?

Kthehemi edhe një herë në atë sesi Krijuesi kur ia dha gjithçka deshi njeriut, që të veprojë lirisht në to, nuk kishte për qëllim që këto gjëra të ngeleshin pronë legjitime e njeriut, nisur nga vetë fakti se Ai ia mori këto gjëra njeriut sërish.

Po kështu Krijuesi ia mori përsëri njeriut gjithsa i dha, dhe me këtë nuk kishte për qëllim që t'ia rrëmbente atij këto gjëra që me dëshirën e Vetë sovrane ia dha. As kishte për qëllim që të nxirrte në pah fuqinë e Tij sesi Ai mund t'ia rrëmbejë kur dhe si do gjërat që me dëshirën e tij i dha, sepse po të ishte kështu, Ky Krijues Bujar s'kishte për t'ia dhënë që në fillim njeriut begatitë dhe mirësitë fisnike të pafund që i dha. Kjo cilësi e ulët s'është cilësi e një njeriu të mirë e jo më e Zotit Bujar.

Gjithashtu cilësia e rrëmbimit dhe ajo e reklamimit të forcës bien ndesh direkt me cilësitë hyjnore të bujarisë, mëshirës dhe butësisë së Allahut që i gjejmë të shpalosura në mbarë horizontet e kësaj ekzistence.

Atëherë, Krijuesi ia dha njeriut gjërat që posedon dhe nuk kishte për qëllim që të bëheshin pronë e patundshme e tij, ia mori prapë dhe s'kishte për qëllim t'ia rrëmbente apo të reklamonte forcën...

Lind pyetja: Përse Ai ia dha njeriut gjithçka njeriu posedon? Përgjigjja e natyrshme është: Krijuesi ia dha njeriut për një periudhë të afatizuar kohore gjërat që posedon me qëllim që ta provojë atë në lidhje me prestigjin dhe përgjegjësinë që i dha. Të shohë se çfarë do të bëjë dhe si do të punojë. Tashmë ky fakt u bë mëse i qartë.

Thamë se qëllimi që fshihet pas gjithë kësaj është që të provohemi se si do veprojmë dhe përmendëm shembullin kur ti hyn në një provim praktik, të jepen mjete pune dhe pas një farë kohe të merren prapë, pse të jepen dhe të merren prapë? S'ka dyshim se kjo bëhet sepse ti ishe në një provim.

7 - Jeta e kësaj bote është përsosur e atillë që në të të realizohet provimi i njeriut.

A mundet që ndokush nga njerëzit të japë dorëheqjen nga provim "jetë" duke u shprehur se nuk preferon të hyjë në këtë provim? T'i kishte rënë shkurt kësaj pune?

A nuk thamë se Allahu i Lartësuar e ka bërë këtë botë një provim për njeriun?! Mirë pra, unë -mund të thotë dikush- nuk dua të provohem. E në këtë formë çdokush të vepronte në kokë të tij?

Jo, jo o njeri. Nuk ka rrugë tjetër përveçse të hysh në provim, deshe apo nuk deshe. Pse?

Sepse ty do të të marrë uria dhe patjetër do të rendësh pas ushqimit, do të të marrë etja dhe patjetër do të kërkosh ujë, do të duhet të takohesh me njerëzit dhe t'u përgjigjesh detyrimeve reciproke në mes teje dhe tyre, deshe apo nuk deshe.

Përderisa erdhe në këtë botë duhet që patjetër të provohesh dhe faktorët që e bëjnë njeriun të bëhet personazh i këtij provimi janë të detyrueshëm. **Kjo është e para.**

Së dyti. Nëse i vërejmë njerëzit do gjejmë se njëri është i fortë e tjetri i dobët, njëri i pasur e tjetri i varfër, njëri bujar e tjetri koprac, njëri i mirë e tjetri i keq...

Përse kështu? Përse Zoti nuk i krijoi të gjithë njëlloj? Të gjithë të fortë ose të gjithë të dobët, të gjithë të pasur ose të gjithë të varfër, të gjithë bujarë ose të gjithë kopracë, të gjithë të mirë ose të gjithë të këqinj...?

Përgjigjja është: Allahu i Lartësuar nuk i krijoi njerëzit të tillë sepse në mungesë të elementëve në fjalë, provimi -për të cilin Allahu i solli njerëzit në këtë dynja- nuk do të mund të realizohej.

Ky pra është i fortë e ky tjetri i dobët. Përse? Pse nuk i bëri që të gjithë të fortë ose që të gjithë të dobët?

Përgjigjja: Sepse ecuria e provimit do stononte dhe ai nuk do mund të përmbushej.

Do të humbte kuptimin një pyetje prej pyetjeve të qëllimit të ekzistencës njerëzore. Dhe pyetja në këtë rast është se çfarë do të bëjë i fortë me të dobtin dhe se si do të reagojë i dobëti përpara të fortit? Si do të veprojë i fortë dhe si i dobëti?

Disa herë e gjejmë besimtarin të jetë i dobët, kurse mosbesimtarin të fortë dhe me potencë.

Vërehet në këtë rast se a do të bëjë qëndresë besimtari i vobekët kur të ballafaqohet dhe konfrontohet me mosbesimtarin e fortë. Pra një provim.

Kurse në disa raste të tjera gjejmë që besimtari të jetë i fortë kurse të tjerët veç tij, besimtarë apo mosbesimtarë qofshin, i gjejmë të jenë të vobekët.

Vërehet në këtë rast si do të veprojë me ta besimtari i fortë? A do t'i respektojë parimet e mesazhit hyjnor që ftojnë për respektim të drejtash dhe drejtësi apo do të verbohët nga llustra e prestigjit dhe pushtetit dhe do t'i cënoj të drejtat e të tjerëve? Provim...

Ky dijetar kurse ky tjetri i pashkolluar. Si do të veprojë i dituri me të paditurin? A do ta shfrytëzojë makutërisht i dituri injorancën dhe naivitetin e të paditurit?

A do ta ndjekë ky njeri i paditur dijetarin nëse ky i fundit kalon caqet e drejtësisë hyjnore? Edhe ky një provim...

Ky i bukur kurse ky tjetri i shëmtuar. I bukuri a do ta shfrytëzojë bukurinë e tij për të cënuar nderin e të

tjerëve, për të joshur gratë e botës, dhe ajo tjetra e bukur a do e shfrytëzojë bukurinë e saj për t'i joshur njerëzit në imoralitet, digjenerim dhe gjëra të tjera që i ka ndaluar Zoti i botërave?

E kështu me rradhë. Mendo dhe do të gjesh se pas gjithsa i është mundësuar dhe dhënë njeriut fshihet një qëllim i vetëm, provimi.

Ky i zgjuar dhe ky tjetri mendjelehtë. Si do të veprojë i zgjuari me mendjelehtin? A do ta shfrytëzojë për keq mendjelehtësinë e tij?

Ky person i takon një kombi të zhvilluar kurse ky tjetri një kombi të prapambetur. I pari i pasur kurse i dyti i varfër. I pasuri i përparuar si do të veprojë me të varfërin e prapambetur?

Gjithsa përmendëm më lartë i takojnë marrëdhënieve shoqërore.

Gjithashtu gjejmë në këtë dynja shëndet dhe sëmundje.

Si do të reagojë njeriu kur është shëndoshë e mirë? A do ta falenderojë Zotin e tij për këtë mirësi dhe a do ta përdorë për mirë apo për keq shëndetin e tij? Po i sëmuri si do të veprojë, a do durojë, a do e kuptojë se ç'është mirësia e shëndetit?

Kështu pra, do të gjesh se gjithsa e rrethojnë njeriun prej ligjeve, gjallesave apo orendive e sendeve që ka rreth e rrotull, janë mjete me të cilat ai provohet.

Po deshëm të njohim ligjësitë që diktojnë gjendjet dhe rrethanat me të cilat Allahu e provon njeriun do i gjejmë të përshkruara në Kuran me fjalët "e keqja dhe e mira":

"...ju përballim me të keqen dhe të mirën për t'ju sprovuar." El-Enbija (35)

Pra provim me të keqen dhe me të mirën.

Por a s' do mjaftonte që Krijuesi të na sprovonte vetëm me të keqen?

-Vërtetësia e Jetës-

Përgjigjja është jo, sepse provimi që nxjerr në pah të vërtetën që fshihet në zemrat njerëzore nuk mund të bëhet përveçse duke e kthyer dhe vërtitur njeriun nga një gjendje në një tjetër.

Kapim shembujt kur besimtarët janë sprovuar në besimin e tyre nëpërmjet persekutimeve dhe keqtrajttimeve makabre.

Gjithmonë ka patur në mesin e tyre heronjë të vërtetë që i kanë përballuar me guxim këto persekutimi dhe keqtrajttime. Ata kanë rrëmbyer armët dhe kanë luftuar në emër të besimit.

Kurse ka patur të tjerë që kanë qenë tepër të guximshëm dhe kanë luftuar armiqtë e tyre jo në emër të besimit, por në emër të fisit apo kombit të tyre, për të ngritur lavdinë dhe famën personale, farefisnore apo kombëtare.

Ka patur të tjerë që kanë luftuar për të mbrojtur aleatët e tyre ose për të nxjerr në pah trimërinë dhe guximin e tyre dhe jo në emër të besimit. Për t'u shpërblyer njeriu sipas qëllimit për të cilin ka luftuar.

Kush ka rënë në luftë për kombin, por nuk e ka bërë këtë në emër të besimit, i tilli ndoshta do të shpërblehet dhe nderohet nga bashkëkombësit e tij, porse ky shpërblim dhe nderim nuk do t'i kalojë caqet e dynjasë.

Kush ka rënë në luftë për të nxjerrë në pah trimërinë e tij dhe për t'u mburrur me të, por jo në emër të besimit, ndoshta disa breza do ta përmendin trimërinë e tij, porse kjo trimëri do të shuhet në dynja dhe nuk do t'i kalojë kufijtë e saj.

Kurse kush ka rënë në luftë për të qenë fjala dhe urdhri i Allahut suprem në këtë dynja, i tilli ka rënë dëshmor në rrugë të Allahut dhe do të nderohet nga njerëzit e mirë e të sinqertë në këtë botë, për t'u pasuar ky sinqeritet i tij me shpërblim në Parajsën e begatë dhe të përjetshme, Xhenetin e lumturisë dhe rinisë së pafund.

Pra njeriu provohet nëse ai lëviz në rrugët e jetës me nxitjen besim apo me ndonjë nxitje tjetër.

Porse Zoti ynë nuk i sprovon njerëzit vetëm me vështirësi dhe sprova të këqia, por i provon edhe me begatitë, diturinë, pushtetin apo pasurinë që u ka dhënë.

Cakton vendimi hyjnor që filan njeriu t'i jepet pushtet, tjetrit pasuri, tjetrit dituri, dikujt të gjitha së bashku, dikujt disa prej këtyre mirësive... vetëm për t'i provuar se si do veprojnë.

I njëjti person kur u sprovua me të këqijat që i ranë mbi kokë u tregua mirënjohës, durimtar dhe i qëndrueshëm, kurse tani, që provimi të realizohet sa më mirë, kthehet në anën tjetër...

Vetëm një gjë e tillë mundëson një testim dhe verifikim të saktë të ndjenjave të zemrës së njeriut. Krijuesi e provon atë me vështirësi dhe pastaj e kthen dhe e provon me mirësi, ashtu që të dalë në pah realiteti i vërtetë që fshihet brenda tij.

Prandaj dijetarët kanë thënë se për besimtarin provimi më i lehtë është provimi me vështirësi dhe sprova të këqia.

Po po. A nuk ke parë sesi shumica dërrmuese e të varfërve e besojnë Zotin, e kujtojnë dhe i luten shumë Atij.

Po kështu edhe shumica dërrmuese e të sëmurëve, të frikësuarve dhe nevojtarëve, sesi i luten Zotit dhe besojnë sinqerisht tek Ai.

Kurse në krahun tjetër shumicën e të pasurve, pushtetarëve dhe të fortëve i gjen neglizhent karshi kujtimit të Zotit, lutjes Atij dhe besimit në Të.

Pra prej elementëve më të lehtë të provimit dynja është provimi me të keqen në lidhje me të cilin Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“Do t’ju sprovjmë me frikë, uri, humbje në pasuri, në shpirtërat njerëzore, në të vjelat (bujqësi),

e ti (o Muhamed) përgëzoi durimtarët të cilët kur i godet ndonjë fatkeqësi (nxjerrin në pah besimin e tyre kur) thonë “në të vërtetë ne (dhe gjithsa posedojmë) jemi (krijesa dhe robër) të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi.” El-Bekare (155-156)

Ky është provimi me vështirësi dhe sprovë të këqia. Siç thotë thënia Kuranore, e keqja është shumëllojëshe. Në të hyn uria, frika, humbja në pasuri në përgjithësi dhe në prodhimtarinë bujqësore në veçanti, humbja në shpirtërat njerëzor -vdekja- si dhe fatkeqësitë e tjera që e prekin njeriun.

Të gjitha mbajnë një emër, provim.

Në një tjetër thënie Kuranore, Allahu i Lartësuar thotë: *“Sikur ata (mosbesimtarët) t’i përmbaheshin rrugës së drejtë (Islame), Ne do t’u lëshonim atyre ujë me bollëk, për t’i sprovuar me këtë (begati)...”*

El-Xhin (16-17)

Kjo thënie është e ngjashme me thënien e Allahut të Lartësuar në thënien Kuranore numër 96-të, të kaptinës Kuranore El- Earaf: *“Ë sikur banorët e atyre vendbanimeve të këshin besuar dhe të ishin ruajtur (nga mëkatet), Ne do t’u zbrisnim atyre begati nga qielli e toka...”*

Dhe thotë: *“Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete me të cilën i kënaqëm disa prej tyre (mosbesimtarëve), për t’i sprovuar me këtë...”*

Taha (131)

Allahu i Lartësuar në këto thënie Kuranore thotë “do u jepnim atyre”. Për çfarë? Përgjigjet thënia Kuranore duke na thënë se Allahu do t’u jepte atyre begati dhe të mira me qëllim që t’i provojë me këto të mira. Pra për t’i vënë në provë. Thëniet Kuranore të kësaj natyre janë të shumta dhe në total këto thënie Kuranore tregojnë se Allahu i

Lartësuar e ve në provë njeriun me vështirësi e fatkeqësi por edhe me begati e mirësi.

Ky lloj provimi mund të jetë në nivel personi por mund të jetë edhe në nivel shoqërisht apo popujsh.

Vetë mosbesimtari është sprovë për besimtarin dhe anasjelltas.

Përsa i përket provimit në rang shoqërisht apo popujsh përmendim faktin sesi njëherë filan popull është më i fortë dhe më i zhvilluar ndërkohë që një popull nevojtar, fqinj apo i largët, është më i dobët dhe i prapambetur, dhe më pas gjendja mund të përmbysset e të ndodh e anasjellta.

E kështu me rradhë. Përse?

Përgjigjja, për t' u provuar në rang shoqërisht apo popujsh...

Ja se çfarë thotë Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik në lidhje me këtë çështje:

“...E këto ditë i rrotullojmë (këmbejmë) në mes njerëzve...” Eli Imran (140)

Një ditë pro teje e tjetra ndoshta kundra teje.

Këmbehen gjendjet dhe rolet. Kurrë nuk i gjen njerëzit dhe shoqëritë njerëzore gjithmonë në një gjendje.

Sigurisht që Allahu i Lartësuar ka vendosur ligje që çojnë në ndryshimin për mirë ose keq të gjendjes dhe parimi hyjnor që na ka ardhur nëpërmjet Kuranit Fisnik na ka mësuar se “Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një kombi derisa ata vetë të ndryshojnë vetvetet e tyre”.

E gjitha kjo hyn tek provimi dhe ligjësitë e tij.

Vetë ti o njeri, je në një provim. Njerëzit që ke rreth e rrotull janë ata me të cilët provohesh, kurse ata në krahun tjetër provohen me ty.

Provohesh edhe me shokun tënd, kolegun tënd, nëse të hynë smira dhe paragjykon për të kur ai bën diçka, apo veç mirë mendon, dëshiron dhe bën për të. A e urren, e ke inat dhe do që ai të pësojë disfatë në

dhuntitë dhe mirësitë që ka, apo ti i lutesh Zotit të bëhesh si ai, por pa patur në zemër smirë për të dhe pa dëshiruar që ai të pësojë ndonjë disfatë në dhuntitë dhe mirësitë që Zoti i ka dhuruar?

A ia do të mirën atij siç ia do të mirën vetes apo zemra jote është e nxirë dhe ti dëshiron për të rrënimin dhe shkatërrimin?

Provim. A do të tregohesh i thjeshtë dhe modest me të apo jo? A do t'ia japësh atij të drejtat të cilat t'i ka obliguar dhe mësuar Islami, besimi yt, apo jo? A do ta këshillosh duke dëshiruar të mirën e tij? A do rrëshqasësh në përgojimin e tij? Provim. Me shokun, të afërmit dhe mbarë njerëzit...

Vetë Allahu i Lartësuar thotë në fjalën e Tij, Kuranin Fisnik:

“...Ne iu bëmë juve sprovë për njëri-tjetrin, në, do duroni? E Zoti yt sheh do gjë.” Furkan (20)

Filani tha për ty kështu, të shau...

E ti nga ana jote si do të reagosh, a do ta shashë edhe më keq, pasi mësove se Kurani të thotë se ky është një provim: *“...në, do duroni?”*.

Provim në rang personash, grupimesh, shoqërisht, vendesh dhe popujsh.

Mbarë ecurinë e kësaj jete nuk mund ta komentojmë ndryshe veçse një provim, testim. Apo s'është kështu?!

Por, kur mbaron ky provim? Mbaron me vdekjen. Ja, kështu. Deri kur të vdesësh ti je në një provim. Engjëjt në të djathtën dhe të majtën tënde rregjistrojnë.

Vetë toka rregjistron dhe do të jetë dëshmitare pro ose kundra teje, fakt ky që tashmë është vërtetuar shkencërisht.

Shkencëtarët kanë vërtetuar se veprimet e njerëzve mbi planetin tokë ruhen me zë dhe figurë në arkivën e planetit tokë.

Asgjë, asnjë zë dhe asnjë imazh i asaj çfarë ka punuar njeriu nuk humbet, porse ngelet i rregjistruar.

Këtë fakt e zbuluan shkencëtarët kur projektuan kamerat speciale nëpërmjet të cilave -falë ligjeve të termodinamikës me të cilat Krijuesi e ka pajisur universin-, arritën të filmojnë gjurmët e mbetura prej ngjarjeve që kanë ndodhur në atmosferën e tokës.

Nëpërmjet kësaj kamere shkencëtarët arritën ta filmojnë ngjarjen disa ditë pasi ajo pati ndodhur.

Kam lexuar me sytë e mi në një gazetë shkencore titullin e një materiali që bënte fjalë për ritransmetimin dhe rikthimin nëpërmjet metodës në fjalë të historisë së tokës.

Bëhet fjalë për një qendër studimoro-shkencore në Evropë, lëmi i kërkimeve të së cilës është bazuar pikërisht mbi këtë ligjësi të mahnitëshme.

Shkencëtarët janë bazuar në faktin se çdo gjë që ka ndodhur dhe ndodh në tokë është e rregjistruar dhe stampuar në atmosferën e planetit tokë.

Argument për këtë janë materialet filmike që falë kamerat speciale që përmendëm më parë janë arritur të filmohen disa orë, dhe më pas disa ditë pas ngjarjes së tyre.

Shpresohet që aftësia incizuese e këtyre kamerave të kalojë kufijtë e orëve dhe ditëve, drejt historisë së lashtë të tokës dhe banorëve të saj.

A s'është ky një tjetër argument bindës që vërteton se njeriu në këtë botë provohet?!

Kështu pra, toka rregjistron. Lind pyetja se përse toka jonë dhe atmosfera e saj janë krijuar të tillë që rregjistrojnë çfarë ndodh në to. Përse?

Përgjigjja është: Dihet mirë që qëllimi i vetëm prej incizimit është ritransmetimi. Apo jo?!...

Përderisa është vërtetuar se në tokë dhe atmosferën e saj ngjarjet rregjistrohen, madje tek evropianët gjendet një qendër kërkimoro-shkencore që synon rikthimin dhe ritransmetimin e historisë tokësore, e gjitha kjo tregon se ngjarjet janë rregjistruar në këtë formë ashtu që një ditë të ritransmetohen...

Mbi këtë fakt është hedhur dritë, afërsisht 1400 vjet para se ai të zbulohet nga shkenca, në kaptinën Kuranore “Ez-Zilzele-Dridhja” në të cilën Allahu i Lartësuar thotë:

“Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme. Dhe të nxjerrë toka atë që ka në brendinë e saj... Atë ditë ajo (toka) i rrëfen tregimet e veta (që kanë ndodhur në të)... E kush punoi një të mirë sa grimca atë do ta shikojë. Kush punoi një të keqe sa grimca, atë do ta shikojë.”

Ez-Zilzele (1, 2, ...4 ...7, 8)

Në lidhje me komentimin e kësaj thënie Kuranore, shoku i profetit Ebu Hurejra, ⁶ transmeton se Profeti i Allahut Muhamedi -lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të-, një ditë prej ditësh lexoi ajetin e sures “Ez-Zilzele” ku Allahu i Lartësuar thotë:

“Atë ditë ajo -toka- do të rrëfejë lajmet (ngjarjet) e saj.”, dhe pastaj u tha atyre që ishin të pranishëm: *“A e dini se cilat janë lajmet e saj që do të rrëfejë?”* Të pranishmit thanë: Allahu dhe i dërguari i Tij e dinë më së miri. Tha: *“Lajmet e saj janë dëshmia e saj për atë që punoi mbi të çdo rob dhe robëreshë (e Zotit). Do thotë punoi këtë dhe këtë.”* Tha: *“Këto janë lajmet e saj.”*

Kjo thënie Kuranore, e përkrahur edhe nga thënia profetike në fjalë, tregon se toka do dëshmojë një ditë prej ditëve dhe do të sjell ty atë çfarë punove mbi të.

Pra të njëjtën gjë që ti bëre mbi tokë ajo atë ditë e bënë të dëshmueshme me zë dhe figurë, origjinal siç ka ndodhur.

Ndërkohë që ne njerëzit në ditët tona mundëm të sjellim një filmim të ekranizuar, Zoti i botërave ditën e

⁶ Transmetim nga Tirmidhiu dhe Bagaviu. Ky i fundit e vlerëson këtë thënie profetike si të saktë.

gjkimit do sjell të njëjtat punë dhe ngjarje, personazhë të së cilave jemi vetë ne që i vepruam...

Krejt siç thotë Allahu i Lartësuar në një tjetër thënie Kuranore: **“Ky është libri ynë (në të cilin janë rregjistruar veprat tuaja), flet për ju drejtësisht. Në të vërtetë, ne e rregjistruam atë çka juve punonit.”** El-Xhathije (29)

Vjen dita e gjykimit dhe falë ligjësive speciale me të cilat e ka krijuar universin Allahu i Lartësuar të thuhet: Urdhëro. Kjo është ajo ç’ka ti ke bërë.

Kurse në një thënie tjetër Kuranore thuhet:

“Dhe (ditën e gjykimit) vihet libri (ku janë rregjistruar dhe ruajtur veprat e njerëzve), e i sheh mëkatarët të frikësuar nga shënimet që janë në të dhe thonë: “Të mjerët ne! Ç’është puna e këtij libri që nuk ka lënë as (mëkat) të vogël e as të madh pa e përfshirë?” E atë që vepruan e gjejnë prezente, e Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt.” El-Kehf (48)

Ata e gjejnë atë çfarë punuan prezente, përpara tyre.

Pra po atë gjë që punuan e gjejnë në atë ditë prezente përpara tyre. Po në lidhje me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: **“Atë ditë (ditën e gjykimit) njerëzit do të dalin të ndarë në grupe për të parë (me sytë e tyre) punët e tyre (e për t’u shpërlyer secili për çfarë punoi në dynja). E kush punoi një të mirë sa grimca atë do ta shikojë (gjejë dhe dëshmojë me sytë e tij ditën e gjykimit). Dhe kush punoi një të keqe sa grimca, atë do ta shikojë.”** Ez-Zilzele (6-8)

Pra i thuhet shikoje me sytë e tu atë që vetë punove. Nëse vëren me kujdes përgjigjja e pse-së së jetës nga çdo plan dhe detaj që ta shikosh është një, për t’u provuar.

Ky është komenti i vetëm me të cilin mund të komentohet realiteti i detajuar i jetës.

8 - Si mund të dalë i suksesshëm njeriu në provimin jetë?

Përpara kësaj duhet të dish se Ai që të provon është Allahu, Krijuesi i Plotfuqishëm. Ti u fute në këtë provim me dëshirën e Tij.

Gjithashtu ty s'të është lënë asnjë mundësi që ta eliminosh apo shtyshë këtë provim. E di mirë se këtij Gjykatësi të drejtë nuk ke mundësi t'i bësh asnjë manipulim. Atij nuk mund t'ia hedhësh.

E pra për ty nuk ngelet veçse një zgjidhje e vetme. Ajo është që të përgatitesh seriozisht për këtë provim. **Kjo është e para.**

Së dyti: Nëse do që të dalësh me sukses në këtë provim dhe të kesh sukses në rrugëzgjidhjen e drejtë të tij, të duhet gjithashtu të kesh kujdes në zgjedhjen e shoqërisë.

Kujdes me kë shoqërohesh!

Nëse ti dhe shokët me të cilët shoqërohesh jeni një shoqëri e mirë, në këtë rast fryma e mirësisë dhe bashkëpunimit pozitiv që dominon në këtë shoqëri ndihmon për të qenë i suksesshëm në lëmin e provimit "jetë".

Në të tillë shoqëri individët ndihmojnë në të mirë njëri-tjetrit. Nëse harron, të kujtojnë; nuk di diçka, ta mësojnë; nuk ke mundësi t'ia dalësh vetë mbanë për diçka, të ndihmojnë; bie në neglizhencë dhe pakujdesi, të zgjojnë; bie në gabim, të qortojnë dhe udhëzojnë...

Por sa fatale është kur ti bie viktimë e një shoqërie të keqe, krejt të ndryshme nga kjo e para.

Nëse bie në neglizhencë, të zhysin edhe më tej në të; bie në gabim, të duartrokasni dhe me këtë qëndrim të tyre të thellojnë më tej në gabim; harron, ta shtojnë më keq harresën; je i dobët, ta shtojnë edhe më shumë dobësinë; tenton të bësh diç të keqe, të fryjnë në vesh që ta bësh realitet atë...

Prandaj nga shkaqet më të rëndësishme të daljes me sukses në provimin "jetë" është zgjedhja e shoqërisë tënde, që shoqëria jote me të cilët shoqërohesh të jetë e zgjedhur, ashtu siç na mëson Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik:

"Përkufizojë veten tënde (bëj durim e qëndro) me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, që synojnë kënaqësinë e Tij dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote. Mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën prej përkujtimit Tonë dhe i është dhënë epshit të vet, sepse puna e tij ka mbaruar." El-Kehf (28)

Kjo thënie Kuranore na urdhëron të shoqërohemi me besimtarët e mirë dhe të devotshëm e të mos i bindemi dhe shkojmë pas mendjelehtëve.

Po në lidhje me këtë çështje, Allahu i Lartësuar në një tjetër thënie Kuranore thotë:

"Atë ditë (në Botën Tjetër) zullumqari i padrejtë do t'i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: "I mjeri unë, ta kisha ndjekur rrugën e Profetit (rrugën e besimit Islam)! O shkatërrimi im! Ah të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej saj. E djalli është ai që njeriun e humb dhe e lenë të vetmuar (e braktis)."

El-Earaf (27-29)

-Vërtetësia e Jetës-

Vëreni sesi Allahu i Lartësuar e quajti në këtë thënie Kuranore shejtan -djall- shokun e këtij personi që u bë shkak për largimin e tij nga besimi i drejtë, ndonëse ky është prej njerëzve.

Shoku i tillë tregohet i pabesë.

Sa herë që ndërmerri një vendim të sinqertë të zbraps nga ai.

Sa herë që vendos të afrohesh tek Zoti yt ai të vendosë lloj lloj pengesash.

Pra kjo jetë s'është veçse një provim e betohem në të Madhin Zot se nuk ka asnjë rrugë për ta eliminuar këtë provim.

Ndërkohë që shoqëria e mirë është një shkak më tepër që mund të të ndihmojë në rrugën e suksesit, dije se i Vetmi që mund të ta dhurojë suksesin është Allahu i Lartësuar.

Vetëm Ai e ka në dorë mbarësinë dhe suksesin. Kërkoje pra ndihmën dhe përkrahjen e Tij, sepse vetëm kështu do të mund të dalësh me sukses në provimin "dynja".

Si thua? Nëse ti ke një profesor të aftë që bën provime me të vërtetë mjeshtërore dhe në një prej këtyre provimeve që është vendimtar për ty, ndër të tjera të bien pyetje me të vërtetë të vështira, si do të vejë halli yt?!

Por sa gjë e bukur kur një profesor tjetër, ndonëse më mjeshtër dhe profesionalist se i pari, e ndihmon cilindo nxënës që i kërkon atij ndihmë.

Nxënësi e pyet dhe i kërkon që ta udhëzojë sesi të hyjë në rrugëzgjdhjen e kësaj pyetje dhe asaj tjetrës, e ai nuk ngurron por e mëson kështu e kështu -e për Allahun është shembulli më i lartë-.

Po po. Sigurohu se sado i vështirë që të jetë provimi, sukcesi është i garantuar për atë që formon

një lidhje të ngushtë me Krijuesin e Tij, një lidhje të denjë.

Dije se ti do të kesh mbarësi dhe sukses në këtë provim vetëm nëse Allahu i Lartësuar do të ndihmojë, prandaj afrohu tek Ai, kërkoi Atij ndihmë, mbështetu vetëm tek Ai dhe lidhu ngushtë me Të.

Me çdo gjë që kryen syno kënaqësinë e Tij. Çdo gjë që shikon se e kënaq Allahun, bëje.

Syno vetëm kënaqësinë e Tij. Kur t'i vërtetosh Zotit tënd se ti synon vetëm kënaqësinë e Tij dhe kërkon se si ta kënaqësh Atë, atëherë me siguri që Ai do të të japë dhe do të kënaqë, ashtu siç bëri me të parët tanë të sinqertë për të cilët na thotë në Kuranin Fisnik se: ***“...Allahu u kënaq prej tyre dhe ata u kënaqën prej Tij...”*** El-Bejineh (8)

Kur ti ndjek dhe synon kënaqësinë e Allahut, atëherë Allahu e zgjeron zemrën tënde për pranimin e fjalës së Tij, Kuranit, dhe të udhëzon me të në rrugët e paqta që të dhurojnë lumturinë e të dy botërave.

Pikërisht në lidhje me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“Allahu udhëzon me të (me Kuranin) në rrugët e shpëtimit ata që ndjekin kënaqësinë e Tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në rrugë të drejtë (në Islam).”

El-Maideh (16)

9 - Koncepti islam se toka ku ne jetojmë s'është veçse arena e sprovës.

Allahu i Lartësuar e bëri njeriun trashëgimtar në këtë tokë për një periudhë të caktuar kohore, deri në një afat që Ai e ka caktuar për çdo njeri, por që asnjëri nuk e di.

E bëri njeriun trashëgimtar dhe të parë në tokë, e udhëzoi nëpërmjet udhëzimit hyjnor dhe e provon se si do veprojë.

Pra kjo dynja s'është veçse një provim në të cilin del në pah ai që do t'i bindet Krijuesit dhe ai që nuk do t'i bindet Atij, dallohet besimtari mirënjohës dhe bamirës nga mosbesimtari mosmirënjohës dhe keqbërës.

Dhe kur vjen afati final, trupi i njeriut vdes, për të filluar kështu ekzistenca njerëzore udhëtimin e mahnitshëm në Botën Tjetër ku secili shpërblehet në varësi të asaj që punoi në këtë jetë.

Shkurt, në këtë botë çdo njeri provohet në gjërat dhe mirësitë që ia dha i Madhi Zot, nëse ai do t'i shfytëzojë dhe përdorë ato për atë qëllim për të cilin i krijoi i Madhi Zot dhe ashtu siç kënaqet dhe do Ai, apo jo.

Ky në fakt është edhe kuptimi i adhurimit, sepse siç e thamë edhe më parë **adhurimi nuk është gjë tjetër veçse bindja dhe nënshtrimi karshi orientimeve hyjnore dhe të jetuarit nën udhëheqjen e ndritur të këtyre orientimeve.**

Fakti në fjalë ka ngelur enigmë edhe për disa njerëz të ashtuquajtur inteligjent të cilët i kanë mbushur kokat e tyre me qëllime fallso për këtë jetë.

Se kanë kuptuar dhe për ta s' dimë pse është kaq e vështirë ta kuptojnë se adhurimi -të jetuarit sipas qëllimit për të cilin i krijoi Zoti i tyre- është qëllimi i vërtetë i jetës së tyre dhe të gjithë njerëzve.

Më lejoni t'ju përmend diçka që na lehtëson dhe ndihmon të kuptojmë drejtë konceptin dhe domethënien e adhurimit dhe që në të njëjtën kohë është në vetvete një argument i qartë dhe i shëndoshë logjik në lidhje me çështjen e adhurimit.

A dyshon kush në faktin se **çdo aparaturë që projektohet dhe prodhohet, bëhet me qëllim që të funksionojë dhe punojë sipas qëllimit për të cilin e ka projektuar dhe prodhuar atë ai që e ka bërë.**

Çdokush që prodhon diçka e prodhon atë që ajo të punojë dhe funksionojë për atë qëllim që ky prodhues do. Mikrofonit është prodhuar për të funksionuar dhe punuar sipas qëllimit që ka dëshiruar prodhuesi i tij...

Syzet janë prodhuar që të bëjnë atë rol dhe funksion që ka dëshiruar prodhuesi i tyre. Nuk është e mundur që ato të shfrytëzohen e përdoren përveçse ashtu siç ka caktuar prodhuesi i tyre. Syzet e diellit përdoren për diell e jo për anomalitë e shikimit...

Po kështu edhe çdo gjë tjetër nga gjërat që ka bërë dora e njeriut si lapsi, fletorja, dera, e deri te gjylypëra dhe gozhda, janë krijuar: **“Që të përdoren dhe funksionojnë sipas atij qëllimi që ka dashur ai që i ka bërë”**, gjë që dihet mirë nga të gjithë.

A ka ndonjë vështirësi për ta kuptuar këtë fakt?!...

Përveç njeriut, njeriut ateist, që nuk i bindet këtij parimi. Nuk do të veprojë e punojë sipas atij qëllimi për të cilin e ka krijuar Krijuesi i tij.

Çudi me këta njerëz që dorëzohen para këtij parimi kur bëhet fjalë për gjërat e bëra nga njeriu, por ngurrojnë t'i binden këtij parimi, madje refuzojnë me forcë t'i

dorëzohen atij kur bëhet fjalë për krijesat e bëra nga Krijuesi, Allahu i Urtë dhe Gjithëdijshtëm.

Onjeri i logjikshëm! A ti e krijove vetveten tënde?!... S' ngelet veçse të thotë: Jo... Pra s' e krijove vetveten?!

A mos vallë ti u krijove nga asgjëja, mosekzistenca që nuk ekziston as për vete?!... Të thotë: Jo. Asgjëja që nuk ekziston as për vete nuk mund të sjellë në ekzistencë gjë prej gjëje... Po a ke krijuar ti ndonjë gjë prej gjëje në vetveten tënde apo jashtë saj?!... Të thotë: Jo... Atëherë duhet patjetër ti dhe universi ku jeton ta keni një Krijues. Të thotë: Po unë e kam një Krijues... Po përse të bëri dhe solli Krijuesi yt në këtë ekzistencë? A nuk erdhe në këtë ekzistencë që të punosh dhe veprosh sipas atij qëllimi për të cilin të krijoi Krijuesi yt?! Që të punosh dhe veprosh siç do dhe kënaqet Ai dhe jo ndryshe⁷.

7 Në fakt gjithkush që ndërron qëllimin për të cilin është krijuar ka rënë në një injorancë pa frë dhe ka bërë një krim të shëmtuar. Ç'mendim do të formojmë ne për një person që një send çfarëdo e përdorë në kundërshtim me qëllimin për të cilin është bërë. Nëse për shembull e përdor lapsin për furçë, makinën për ndenjësë dhe vend shplodhje, kurse librin për jastëk. Askush s' do të dyshojë në injorancën dhe shkarjen mendore të tij. Po nëse dikush nga këta mendjelehtë, do ta përdorte ndonjë organ të trupit të tij në kundërshtim me rolin dhe funksionimin e tij të vërtetë, si për shembull ta përdorte hundën për të ngrënë, syrin për të marrë frymë apo gojën për të parë, a do të dyshonte kush në marrëzinë e tij?! Në këtë formë ky njeri do të bënte një krim të shëmtuar, pasi duke ia ndryshuar cilitdo prej organeve të tij rolin e saktë funksional, s'ka dyshim se ai do ta prishte atë. Por edhe më i marrë dhe më shkelës i ligjit suprem të jetës, edhe më kriminel i shëmtuar është ai person që nuk i ndryshon rolin dhe qëllimin thjeshtë një organi apo shqisë të vetme, por ia ndryshon qëllimin ekzistencial tërësisë së qenies së tij materiale dhe shpirtërore, për ta prishur kështu jetën e tij dhe humbur vetveten... (shënim i përkthyesit)

Kështu, ty o njeri i logjikshëm s'të ngelet tjetër veçse të mësosh se çfarë do Krijuesi prej teje.

Për këtë lypset të njohësh dhe vërtetosh se kush është Krijuesi yt i Vërtetë, cilët janë profetët e vërtetë që Ai ka dërguar dhe cilat janë mesazhet e vërteta hyjnore që këta profetë kanë përcjellur nga Zoti i botërave për tek njerëzia.

Pasi ta vërtetosh këtë nëpërmjet mendjes që ta ka dhuruar i Madhi Zot, dije se adhurimi s'është tjetër veçse t'i bindesh këtyre udhëzimeve hyjnore dhe të jetosh madje edhe vdesësh duke u udhëhequr nga këto udhëzime.

Për këtë i krijoi Allahu edhe xhindët, edhe njerëzit, ashtu siç e ka shprehur qartë këtë në Kuranin Fisnik ku thotë: *“Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit përveçse që ata të më adhurojnë Mua.”* Edh-Dheriat (56)

Sa përmendëm e bën çështjen për të cilën po flasim edhe më të kuptueshme.

Parimi logjik që përmendëm është një argument bindës logjik që vërteton faktin se ne njerëzit jemi krijuar për ta adhuruar Krijuesin tonë duke ju bindur udhëzimeve të cilat Ai do që ne t'i ndjekim...

Pra ti o njeri u krijove që të veprosh e bësh atë që do Krijuesi yt. Mirë e kuptova!

Por si mund ta kuptoj se çfarë kërkon prej meje Krijuesi im?

Po a nuk të dërgoi Ai o njeri për këtë gjë profetët e Tij nga njerëzit më të zgjedhur, më të urtë, më këmbëngulës, më kreshnikë, më besnikë, më të mirë dhe më të ndershëm?!

E do më mend kjo gjë për t'u kuptuar?!

Mjaft më përçart!

Le t'i japim fund kësaj neglizhence në lidhje me pse-në më të domosdoshme, me pse-në e ekzistencës sonë.

S'ka ngelur veçse të të vijë gargara finale, të japësh frymën e fundit, e po të gjeti agonia e vdekjes neglizhent karshi përmbushjes së qëllimit për të cilin të krijoi Krijuesi, s'të pret veçse Xhehenemi, Ferri, ku ndëshkohen ata që neglizhuan dhe harruan vetveten.

Në fakt Allahu i Lartësuar i kishte të gjitha mundësitë që ta detyronte njeriun që me pahir ta adhuronte Atë, që ta bënte njeriun që me pahir të vepronte dhe punonte siç do Ai, ashtu siç bëri me zemrën tënde o njeri, që punon dhe funksionon sipas dëshirës hyjnore krijonjëse dhe e zhveshur nga ndikimi yt edhe pse gjendet në brendinë tënde, ashtu siç bëri me mushkëritë e tua që punojnë sipas dëshirës krijonjëse hyjnore natë e ditë, kur ti flen e kur je zgjuar, ashtu siç bëri me të gjithë trupin tënd, ashtu siç bëri me diellin, me hënën, ashtu siç bëri me pemën, me ujin, me ajrin...

Porse Zoti i Lartësuar nuk deshi ta impononte njeriu që me pahir ta adhurojë Atë. Prandaj Ai i krijoi njerëzit trashëgimtarë⁸ sovranë në tokë dhe i pajisi me dëshirë e vullnet të lirë.

⁸ Dikush në lidhje me thënien "Njeriu është trashëgimtar në tokë", mund të pyes se trashëgimtar i kujt është njeriu në tokë? Dijetarët muslimanë i janë përgjigjur kësaj pyetje duke thënë se njeriu është trashëgimtar në tokë i krijesave të tjera që kanë jetuar para tij po në këtë tokë. Dikush ka shprehur mendimin se këta krijesa kanë qenë xhindët dhe ka marrë për argument në lidhje me këtë, thënien Kuranore ku Allahu i Lartësuar thotë: "*E kur Zoti yt u tha engjëjve: "Unë po bëj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës (një trashëgimtar)*

!" Ata -Engjëjt- thanë: "*A do të bëshë në të kë bën çrregullime dhe derdh gjakrat, e ne të madhërojmë Ty duke thurur lavd për Ty dhe duke të adhuruar plotësisht!"* Ai -Allahu- tha: "*Unë di atë që ju nuk e dini!"*" El-Bekare (30)

Këta dijetarë thanë se kjo thënie tregon qartë se para njeriut në tokë ka pasur krijesa të tjera që bënë çrregullime dhe derdhnin

Sepse kjo botë është një provim, dhe nuk mund të provohet ndershmërisht veçse ai që është i lirë të zgjedhë.

Allahu i krijoi njerëzit trashëgimtarë sovranë në tokë dhe u dërgoi atyre profetët me mesazhin hyjnor që njerëzit t'i binden këtij mesazhi dhe kështu ta adhurojnë me bindje dhe vullnet të lirë Krijuesin e tyre gjatë kohës së jetës së tyre mbi tokë.

Kush e ndjek udhëzimin hyjnor, duke iu bindur kështu Zotit të tij, shpëton dhe del i suksesshëm në provimin "jetë", kurse kush refuzon rradhitet ndër të dështuarit dhe të humburit, e gremiset në humbëtirat e Xhehenemit -Ferrit- Besimtari pati sukses në këtë provim sepse ai e njohu Zotin, Krijuesin e tij. E kuptoi se duhet t'i bindet dhe nënshtrohet Atij.

I vetëdijshtëm, i ndërgjegjshëm dhe me vullnetin e tij të lirë e vërtetoi, e mësoi, e studjoi, e ndoqi dhe zbatoi udhëzimin hyjnor që i erdhi nga Krijuesi i tij, edhe pse ai kishte mundësi ta refuzonte dhe kundërshtonte atë. Ai pasi e njohu Zotin e tij nuk mëkatoi edhe pse kishte mundësi dhe ishte i lirë të mëkatonte, prandaj ai e meritoi Xhenetin -Parajsën-.

Kurse në krahun tjetër, mosbesimtari që dështoi në provimin jetë, i mohoi argumentet e Zotit të tij dhe abuzoi me to, e neglizhoi udhëzimin e ardhur për të nga Zoti i tij dhe me vullnetin e tij të lirë e kundërshtoi Krijuesin dhe nuk iu bind Atij, prandaj ai e meritoi ndëshkimin në Xhehenem -Ferrin- e kobshëm.

= gjakra në të, gjë për të cilën vetë engjëjt dhanë opinionin e tyre, siç edhe përmendet në këtë thënie Kuranore. Në lidhje me këtë gjë, krahas kësaj thënie qarkullojnë edhe thënie të tjera, e në përgjithësi këto thënie tregojnë se njeriu është trashëgimtar në tokë i krijësave të tjera, xhind apo njerëz, që jetuan përpara tij në planetin tokë.

10 - Cili është realiteti i kësaj bote, vërtetësia e kësaj jete

Allahu i Lartësuar na e ka zbuluar qartazi faktin se kjo botë është krijuar në një formë të tillë dhe me ligjësi të tilla të habitëshme që të josh, të mashtron dhe të bën të jepesh pas saj dhe zhytesh në vorbullën e saj pa e kuptuar.

Megjithëse dihet mirë e vërteta se gjithsa ka në këtë botë është e destinuar që të zhduket, se njeriu nga një moment në tjetrin mund ta lerë pas këtë botë dhe se ajo s'është veçse e përkohëshme e flakëkashte -e si rezultat i gjithsa thamë kuptohet qartë se kjo botë është pavlerë-, prapëseprapë shumë e shumë prej njerëzve që ishin para nesh e që janë në mesin tonë, u rropatën e rropaten, u dhanë e jepen totalisht, me mish e me shpirt pas saj.

Më pas, krejt befasisht, u detyruan ta lenë pas këtë botë të rreme.

A doni o miqtë e mij ta dini realitetin dhe fytyrën e vërtetë të kësaj bote që kaq shumë të josh dhe ndjell?!

Atëherë imagjino se në këtë moment mbi kokën tënde shpërtheu një raketë, a se ra një tërmet... e ti u ndave nga kjo jetë. Sa vlerë do kishte për ty dynjaja pas kësaj?!

A doni ta dini realitetin e saj?!

Pyeteni veten tuaj se ç'vlerë ka tashmë për ju e gjithë koha e shkuar që ju jetuat në këtë dynja.

Mendo pra! Sa jetova? Sa qesha? Sa qava? Sa u zura? Sa u mundova? Sa u coptova? Sa u kënaqa? Sa u pikëllova? Sa bleva? Sa shita? Sa dëgjova? Sa pashë? Sa fola? Sa shkova? Sa erdha? Sa bëra? Sa ktheva?... Gjithçka shkoi sa vlerë ka tashmë për ty?!

Kur të të vijë befasisht momenti i agonisë së vdekjes, për Zotin që vlera e dynjasë për ty do të jetë sa vlera e jetës tënde të shkuar.

Atë që ne kërkojmë nga stolitë flakëkashte të kësaj bote është po ajo që kërkuan brezat e shkuar.

Kështu këmbehen brezat me njëri-tjetrin dhe ngelet dynjaja. A s'më thoni ku janë gjeneratat dhe popujt e shkuar?!

Ku janë gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë?! Ku është ky e ku është ai tjetri? Ku janë ata që jetonin mbi po këtë tokë para jo më shumë se njëqind vjetësh?!...

Pikërisht në lidhje me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: *“A nuk e kanë të qartë ata se sa breza para tyre kemi zhdukur, ata kalojnë nëpër vendbanimet e tyre (e i shohin me sytë e tyre gjurmët e shkatërrimit të këtyre kombeve të shkuara).”* Taha (128)

Dhe thotë: *“A nuk e panë ata (jobesimtarët) se sa gjenerata kemi zhdukur para tyre dhe ata nuk u kthyen më tek këto të fundit. Dhe të gjithë, të tubuar, do të paraqiten tek Ne.”* Jasin (31-32)

Kurse nesër pyetja do të jetë: Ku do të jesh ti, ku do të jem unë?!

E pra cili është realiteti i jetës së dynjasë?

Miqtë e mij! Kjo jetë është krejt pa vlerë. Vlera e saj është sa vlera e jetës së shkuar prej jetës suaj. Mos t'ju mashtrojë jeta e kësaj bote.

Dynjaja nuk e tregon fytyrën e vërtetë të saj përveçse në çastin e frymës së fundit.

Kur i vjen agonia e vdekjes njeriu e sheh realitetin e kësaj bote dhe thotë: O Zot! O Zot! S'paska qenë asgjë...

Në atë moment kujtohet, por sa vlerë ka?!

Pikërisht në lidhje me realitetin e kësaj bote Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: *“Jeta e kësaj bote s'është tjetër veçse përjetim (dëfrim) dhe lojë. Jetë e vërtetë në fakt është jeta e Botës së Ardhëshme, sikur ta dinin?!”* El-Ankebut (64)

Jeta e vërtetë dhe reale nuk është kjo.

Jeta e vërtetë dhe reale është atje, në Botën Tjetër.

Në këtë jetë po të thanë ha e pi ç'të duash, e gjithë bota është jotja, t'i nuk do të kesh mundësi të hash veçse aq sa nxë barku yt i vogël.

Nëse t'i sjellin të gjitha frutet e botës, pìrgje, pìrgje, sa malet, dhe t'i shohësh, do hash një, edhe një tjetër, edhe një tjetër dhe pas kësaj s'ta mbushin më syrin e s'të bëjnë më asnjë përshtypje.

Kurse në Botën Tjetër -në Xhenet-:

“Banori i gradës më të ulët të Xhenetit është ai që i rinë mbi kokë dhjetë mijë shërbyes, secili prej të cilëve ka dy tabaka (ushqimesh), njëra prej ari dhe tjetra prej argjendi e në secilën prej tyre ka ngjyrë (larmi ushqimi) që s’ka si ai në të tjerat. Hanë prej të fundit (nga tabakatë me ushqim) ashtu siç hanë nga e para. Provon shijen e mirë dhe kënaqësinë e të fundit ashtu siç provon të së parës. Pastaj e gjitha kjo bëhet erë⁹ prej miskut (parfumit) më të mirë. Ata nuk urinojnë, as nxjerrin jashtëqitje (si në dynja) dhe as kanë ndytësi në hundë.”¹⁰

Kjo është jeta e vërtetë e kënaqësisë.

Vëreni se si banori i Xhenetit, botës së jetës së vërtetë, i ha të gjitha tabakatë me ushqime, madje edhe tabakanë e fundit të tyre, me të njëjtën shije dhe ëndje siç hëngri të parën.

Kjo jetë -dynjaja- është bërë qëllimisht për provim, kurse Xheneti -Parajsa- në Botën Tjetër është krijuar enkas për kënaqësi dhe qejf. Atje ligjësitë janë krijuar të tilla që i dhurojnë njeriut vetëm kënaqësi dhe lumturi. Atje është jeta.

⁹ Pjesa e thënjes profetike “bëhet erë” komentohet qartë në një tjetër thënjë profetike ku profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: *“Banorët e Xhenetit hanë në të dhe pinë. Nuk pështyjnë, nuk urinojnë dhe nuk bëjnë jashtëqitje. “I thanë: Po si i bëhet me ushqimin (që hanë)?” Tha: “Gromësirë (gazra që dalin nga goja zakonisht pas një gostie të mirë dhe të bollshme) me kudërmim të mirë dhe djersë si bulëzat e miskut (parfumit)...”* -Transmeton imam Muslim- (shënim i përkthyesit)

¹⁰ Thënie profetike që transmetohet nga Ibn Ebid-Dunja dhe Tabaraniu. Dijetari i shquar i hadithit El-Mundhiri thotë në librin “Et-Tergib uet-Terhib” se transmetuesit e kësaj thënje profetike janë persona të besueshëm.

-Vërtetësia e Jetës-

Kurse jeta e dynjasë është ligjësuar dhe bërë enkas për t'u provuar. Në Xhenet -Parajsë- rrobat janë prej mëndafshi, stolitë prej ari dhe argjendi, fytyrat të bukura dhe të hijshme si hëna, banorit të tij i janë evituar ndytësitë që dalin nga dy rrugët e jashtëqitjes dhe nga hunda, për banorin e saj në të ka ç'ti dojë shpirti e edhe më tepër, përjetësia, siguria, rinia dhe lumturia në Parajsë janë të garantuara...

Nuk është kjo botë streha e denjë e njeriut të krijuar me botën e ditur të dëshirave dhe ambicieve pakufi. Nuk është kjo botë streha e denjë e robëve të mirë, të bindur dhe të ndershëm të Krijuesit të Plotëfuqishëm. Nuk është kjo botë ajo për të cilën jeni krijuar o njerëz.

Siç kemi thënë ne njerëzit kalojmë nëpër faza. Nuk del në pah qëllimi i vërtetë për të cilin u krijove o njeri vetëm se me përfundimin e fazës së fundit prej fazave nëpër të cilat kalon ekzistenca jote.

Dije pra, se jeta e vërtetë, kënaqësia dhe lumturia e vërtetë janë vetëm atje, në Botën Tjetër, në Parajsën e begatë.

Pikërisht në lidhje me këtë fakt, Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“Gjithçka u është dhënë janë kënaqësi (përjetime të shkurtra) dhe stoli të kësaj dynjaje. Ndërsa ai -shpërblimi- që është tek Allahu (në Botën Tjetër) është shumë më i mirë dhe më i qëndrueshëm. A nuk mendoni?!” El-Kasas (60)

A nuk arsyetoni o njerëz mendjelehtë dhe injorantë?!

Jepesh me mish e me shpirt pas kësaj bote të rreme dhe flakëkashte, dhe lë pas dore e neglizhon botën e lumturisë, sigurisë, rinisë dhe përjetësisë?!

Favorizon këtë botë me kënaqësi të rrejshme ku vdekja mund të të befasojë nga një moment në tjetrin, karshi botës së lumturisë së përjetëshme?!

Miqtë e mij! Ju këshilloj të lexoni dhe dëgjoni sa më shumë materiale që bëjnë fjalë për Xhenetin dhe Xhehenemin, meqëllim që të dini se për çfarë po punoni, çfarë po kërkon, çfarë duhet të zgjidhni.

T'i dëgjojmë, t'i dëgjojmë mirë thëniet që flasin për Xhenetin dhe Xhehenemin, sepse ai që dëgjon, e gjen zemrën e tij të lidhet me çfarë dëgjon.

Kështu do ta njohim siç duhet shtëpinë dhe strehën reale drejt së cilës udhëtojmë.

Dijeni se nga shkaqet më serioze që ka bërë që shumë prej njerëzve të rendin verbërisht pas dynjasë dhe të bien viktima të shturjes, mashtrimit, përçarjes, konfliktit dhe zënkave për karriget dhe ofiqet e kësaj bote, është neglizhenca e tyre karshi Botës Tjetër, harresa e takimit të paevitueshëm në të cilin do ta marrë në llogari njeriun, vetë Krijuesi, Allahu i Lartësuar, harresa e asaj që ka përgatitur Krijuesi i Plotfuqishëm në Parajsën e begatë për njerëzit e mirë besimtarë.

Pikërisht përkujtimi i këtyre gjërave dhe ringjallja e këtyre realiteteve në shpirtërat njerëzor, e bën zemrën të permallohet për Xhenetin, shoqërinë parajsore, dhe e lidh ngushtë me të.

Përkujtimi i Botës Tjetër dhe ndërgjegjësimi për mrekullitë e pakrahasueshme që ka përgatitur Allahu Fuqiplotë në të, e bëjnë zemrën të inkurajohet dhe angazhohet gjithnjë e më shumë në rrugën e triumfit, fitores dhe suksesit të vërtetë, drejt altareve dhe horizonteve të kaltra të botës për në të cilën udhëtojmë, drejt strehës së paqtë, të sigurtë dhe të përjetëshme të lumturisë, rinisë dhe përjetësisë, drejt Parajsës së begatë.

Kurse njerëzve që rendin dhe copëtohen pas kësaj bote u themi:

Dijeni se i gjithë brezi ynë njerëzor, ne dhe ju, mbretërit, presidentët, këta e ata, mendjemëdhenjtë, mburravecët, diktatorët, që të gjithë, pas rreth njëqind vjetësh do të fshihen nga ekzistenca dhe askush nuk do të ngelet në këtë dynja.

Vdekja do vijë e do na thotë: Dilni! Dilni nga kjo botë për të cilën aq shumë u lodhët dhe rropatët, ashtu siç na tregon edhe Kurani Fisnik:

“Sa shumë kopështe dhe kroje lanë pas?! Sa shumë ara të mbjella dhe vendbanime luksoze. E shumë mirësi (të tjera) në të cilat jetonin të lumtur. Kështu (mbaroi me vdekjen çështje e tyre në dynja) dhe (gjërat e lartpërmendura) ua lanë trashëgimi një populli tjetër. Për ta nuk qanë as qielli e as toka dhe atyre nuk iu dha ndonjë afat (nuk iu shty afati i vdekjes)”

Ed-Duhan (25-29)

Atyre iu tha: Dilni!

Dhe pas tyre, për pak kohë, do të vijë një gjeneratë tjetër e në të do të ketë shumë adhurues të verbër që do ta adhurojnë këtë botë dhe stolitë e saj, pastaj edhe ata më pas do të ikin... Për ta nuk do të qajë as qielli dhe as toka.

A mos do të qajë për vdekjen tonë qielli, apo do të qajë mali pa ndjenja e të thotë: Sa keq po më vjen që filani dhe filani ikën e shkuan, dhe të nxjerrë nja dy kokrra lotë. Pasha Zotin, prej tyre s'dalin lotë.

Pas vdekjes tënde qielli do ngelet po ai qiell, dielli po ai diell, ylli po ai yll, hëna po ajo hënë, kurse ky njeri mendjelehtë u soll në botën e tyre për t'u provur dhe ju tha: Dil! Ec, përjashta!

Të mjafton të meditosh në vetveten tënde dhe do ta pikasësh vlerën e vërtetë të dynjasë.

Hë pra, sa vlerë ka tashmë gjithë sa kaloi prej jetës tënde?

Për çdo moment që kalon jeta jote pakësohet dhe nga e shkuara e saj në dobinë tënde nuk janë veçse veprat e tua të mira.

Nuk do të kalojnë vetëm se disa vite, muaj, ditë, orë apo sekonda dhe momenti fatal i vdekjes do të zbulojë para teje realitetin e tërë jetës tënde.

Kështu do të bëhet me të gjithë njerëzit e brezit tënd njerëzor dhe me të gjithë njerëzit e brezave që shkuan dhe do të vijnë.

11- Përse kjo botë e rrejshme na josh pa masë dhe na duket si e përjetëshme?

Ishte dëshira e Krijuesit të Gjithmëshirshëm që kjo botë, megjithëse jetë prove dhe tranzitore, të jetë e këndëshme dhe e rehatëshme.

Allahu i Lartësuar e stolisi Botën Tjetër, e bëri besimin të dashur për zemrat e singerta, na udhëzoi në rrugën e drejtë dhe në të njëjtën kohë e stolisi dynjanë, e bëri të këndëshme për zemrat dhe na orientoi në rrugën nëpërmjet së cilës bashkojmë në mes dy mirësive, asaj të kësaj dynjaje dhe asaj të Botës Tjetër.

. Personi që ka besimin e fortë dhe frikë-respektin kundrejt Zotit të tij të madh, zgjedh rrugën e Zotit të tij, udhëzimin e Krijuesit të tij, u bën ballë ngacmimeve të djajve, i edukon epshet e tij, nuk mashtrohet nga stolia dhe ilustra e rreme e dynjasë dhe nuk devijon nga rruga e drejtë.

Kjo gjë i dhuron atij lumturi në këtë botë dhe në tjetrën.

Ky është provimi e ky është kurorëzimi i tij me sukses.

Ndërsa njeriun që ka një besim të dobët karshi Krijuesit të tij, e mashtron dhe verbon ilustra e rreme e kësaj bote, dhe vërsulet shfrenueshëm, me çdo rrugë dhe metodë, kur ia do interesi edhe duke joshur, mashtruar, prishur dhe pse jo edhe vrarë, në kërkim të përmbushjes së epsheve dhe lakmive makute dhe provokatore që ndjellin mirësitë e venitura të kësaj dynjaje. Me këtë del në pah edhe besimi i rremë dhe shturja e këtij personi.

Ky është provimi dhe ky është dështimi.

Pikërisht në lidhje me këtë fakt Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“Gjithçka është mbi tokë, Ne e bëmë stoli të saj, për t’i provuar ata (njerëzit), se cili prej tyre do të jetë më vepërmirë.” El-Kehf (7)

Dhe thotë: *“Njerëzve u është zbukuruar dashuria kundrejt gjërave të këndëshme, grave, djemve, pasurisë së depozituar në ar dhe argjend, kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, e tek Allahu është e ardhmja më e mirë.”* Eli Imran (14)

Dhe thotë: *“Ata që nuk e dëshirojnë dhe presin takimin Tonë, që u kënaqën me jetën e kësaj dynjaje dhe u stabilizuan në të dhe ata të cilët kundrejt argumenteve tona u treguan indiferentë, të tillët do të kenë për vendqëndrim zjarrin (e Xhehenemit), shpërblim për atë çka punuan.”* Junus (7-8)

A e shikoni se cili është faji dhe gabimi i tyre?

Faji i tyre është se u kënaqën, stabilizuan dhe kërkuan prehje totale në jetën e kësaj bote. A ka më injorancë se kjo?!

Krejt si një person që hip në një urban dhe udhëton në të për në një stacion të afërt. Kur ja, zen një sendilje dhe hypur në të thotë: “Jam shumë rehat këtu. Dua të qëndroj në këtë urban.” O njeri! Pas pak do të thuhet zbrit, stacioni i fundit...

Të tillë injorantë janë të gjithë ata që u kënaqën me jetën e kësaj dynjaje dhe tentuan të stabilizohen dhe prehen në të. U treguan të pavëmendshëm kundrejt argumenteve të Allahut dhe udhëzimit të Tij.

Kurani -mesazhi hyjnor- flet dhe tërheq vërejtje, argumentet e Zotit vërehen qartazi, ndërsa ata zhytur në neglizhencë as që duan t’ia dinë. Porse për këta të marrë, të pabindur, naivë dhe ironikë, është përgatitur një gjë që do ta ballancojë dhe shlyejë këtë pozicionim të tyrin.

“...të tillët do të kenë për vendqëndrim zjarrin, shpërblim për atë çka punuan.” Junus (8)

“Shpërblim” për ta sepse u treguan kryeneçë dhe mendjemëdhënë para mesazhit dhe argumenteve të qarta të Allahut.

Ky pra është njeriu, një trashëgimtar të cilin e mundësoi Zoti i tij të sundonjë përkohësisht në tokën e Zotit të vet. Ai është rob i dëshirës sovrane të Këtij Krijuesi Fuqiplotë, e si rezultat ai duhet t’i bindet Allahut të Lartësuar, Krijuesit, Zotit dhe Sunduesit të njerëzve dhe mbarë universit. Allahu i Lartësuar e mundësoi njeriun që të jetë trashëgimtar dhe sundimtar i lirë në këtë tokë, vetëm që të dilte në pah qartazi besimtari i bindur nga mosbesimtari i pabindur. Gjithashtu Allahu i Lartësuar e stolisi për njeriun dynjanë kalimtare në të cilën njeriu provohet, dhe në krahun tjetër, nëpërmjet fjalës së Tij, Kuranit Fisnik, na tregoi edhe për stolitë kulminante të Xhenetit në Botën Tjetër. E njeriut s’i ngelet veçse të reflektojë dhe të zgjedhë.

Nëse njeriu është i singertë, i arsyeshëm dhe besimtar karshi argumenteve të qarta të ardhura nga Zoti i tij, atëherë ai zgjedh udhëzimin e Zotit të tij dhe i jep përparësi Botës Tjetër të përherëshme karshi kësaj bote kalimtare dhe të përkohëshme.

Kurse nëse ai është besimtar i dobët, i shthurur ose i rremë, atëherë atë e joshë Ilustra flakëkashte e kësaj dynjaje kalimtare dhe devijon nga udhëzimi hyjnor.

Kështu pra, dynjaja s’është veçse një botë provë dhe gjithë çfarë gjendet në të janë mjete prej mjeteve të këtij provimi. Me vdekjen e njeriut mbaron për të koha e këtij provimi, dhe njeriu transferohet nga bota e provimit për në botën ku merren rezultatet, për në botën e gjykimit dhe shpërblimit.

12 - Qëllimi i krijimit të njeriut

E pra njeriu qenka krijuar për të qenë trashëgimtar dhe sundues i përkohshëm në tokë. Ky prestigj dhe përgjegjësim i është dhënë njeriut nga Krijuesi i tij dhe i mbarë universit, me qëllim që të provohet në do t' i bindet dhe do ta adhurojë të vetëm Krijuesin e tij, apo do ta refuzojë dhe mohojë Krijuesin e tij dhe nuk do t' i kushtojë asnjëfarë vëmendje mesazhit hyjnor të ardhur prej Këtij Krijuesi enkas për njeriun.

Pastaj, nëpërmjet ligjesisë së vdekjes, Krijuesi e transferon ekzistencën e qenies njerëzore nga bota e punës së lirë për në botën e shpërblimit kundrejt asaj çfarë punoi.

Pikërisht kjo është ecuria dhe vërtetësia ekzistenciale e çdo qenie njerëzore, pavarësisht nga koha apo vendi ku jetoj. Ky është qëllimi i jetës, i njëjtë për çdo qenie njerëzore. A s' është kjo përgjigjja e drejtë? A nuk argumentuam se qëllimi i ekzistencës të gjithë njerëzve duhet patjetër që të jetë i njëjtë? A nuk thamë se njerëzit duke qenë se kanë të njëjtën strukturë fizionomike trupore dhe të njëjtën natyrshmëri të brendëshme, pamvarësisht nga gjuhët, racat, vendi apo koha në të cilën ata kanë jetuar, duhet që qëllimi i krijimit të tyre të jetë i njëjtë.

Makina të tipit Mercedes Benz-2000, të gjitha me strukturë dhe funksionim të së njëjtës natyre. Njëra ngjyrë e zezë, tjetra e bardhë, kurse tjetra ngjyrë tjetër. Njëra katalogun e përdorimit e ka në gjuhën gjermane,

tjetra në anglisht, tjetra në arabisht, kurse tjetra në një gjuhë tjetër.

Njëra gjendet në Amerikë, tjetra në Angli, tjetra në Arabi, kurse tjetra diku tjetër. Njëra prodhuar në vitin 1990, tjetra 2000, kurse tjetra 2100 apo më vonë.

A janë produktuar të gjitha këto makina, pamavarësisht, nga ngjyra, gjuha e katalogut, vendi apo koha, për një qëllim dhe funksionim të njëjlojtë?!...

Kështu, fakti se njeriu është sjellur në këtë botë me qëllim që të provohet, dhe se ky qëllim është i njëjtë për çdo njeri, pamvarësisht nga gjuha, raca, vendi apo koha në të cilën ai ka jetuar, është një fakt i kryer dhe i përkrahur bindshëm si nga mesazhi hyjnor ashtu edhe nga argumentet e shumta logjike.

Dije o njeri se si ti ashtu edhe gjithë bijtë e sojit tënd, keni ardhur në këtë dynja për t'u provuar.

Mos të të kapë mburrja dhe mos të të pushtojë mendjemadhësia o njeri, sepse ti në realitet ke në dorë në këtë ekzistencë vetëm çfarë ka dashur Krijuesi yt dhe i kësaj ekzistence të ta lërë në dorë, e ndërkohë ti nuk ke në dorë as zemrën tënde.

Pas gjithë kësaj që të është lënë në dorë fshihet një qëllim i vetëm, provimi.

I dërguari i Allahut, profeti Muhamed -lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të- thotë: "Secili nga ju është i përgjegjësuar, dhe secili është përgjegjës për atë që ka në përgjegjësi."¹¹

Çdo njeri vdes dhe del nga kjo dynja që të marrë shpërblimin e punës së tij.

Çfarë të mbjellësh do të korrësh...

¹¹ Transmetim nga Buhariu, Ibn Habani, El-Bejhaki dhe En-Nesaiu.

13 - Jeta e mosbesimtarëve

Mosbesimtarët jetojnë vetëm për qëllimet e ngushta të kësaj dynjaje.

Ata pyesin njëri-tjetrin dhe s' dinë të përgjigjen në jetojnë për të ngrënë apo hanë për të jetuar.

Kur bisedojnë ateistët me njëri - tjetrin, kur krerët dhe filozofët e tyre kuvendojnë dhe thellohen në bisedat e tyre filozofike pa frë, njëri prej tyre i drejton tjetrit pyetjen: Ti, a jeton për të ngrënë? I pyeturi mendon e mendon dhe së fundi thotë: Hëm! Dhe befasisht atij i drejtohet pjesa e dytë e pyetjes: Apo ha për të jetuar? Nëse thotë jetoj për të ngrënë, tjetri ia pret: Po përse ha? Thotë: Për të jetuar. I thotë: Po përse jeton? Thotë: Për të ngrënë. I thotë: Po përse ha? Thotë: Për të jetuar. Jetoj për të ngrënë, ha për të jetuar.

Kjo gjë, në këto shoqëri të marra ku sundojnë të tilla filozofi të çmendura, konsiderohet një mister filozofik për të cilin njeriu nuk ka mundur dhe nuk do të mund të gjejë përgjigje.

Ç'filozofi e "përparuar dhe e arrirë"?!
Allahu na ruajtë. Ç'është kjo?

Dihet se ti o njeri jeton nëpërmjet ngrënies me qëllim që të të provojë Zoti yt, dhe më pas vdes për t'u transferuar në botën e gjykimit dhe shpërblimit.

Porse ky është realiteti.

Mosbesimtarët nuk e dinë se cili është qëllimi i ardhjes së tyre në këtë ekzistencë.

Nuk e dinë se përse lindën, përse jetojnë dhe përse një ditë prej ditësh do të vdesin dhe me hir a pahir do ta lenë këtë dynja. Ata dhe kafshët janë njëlloj. Jetojnë pa ditur se përse.

Pikërisht për ta Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik:

“...e ata që nuk besuan kënaqen dhe hanë në këtë jetë ashtu si dhe kafshët, e vendqëndrimi i tyre është zjarri.” Muhamed (12)

Lavdërimi dhe paqja e Allahut qofshin mbi të nderuarin tonë profetin Muhamed, mbi familjen e tij, shokët e tij dhe të gjithë ata që kanë ndjekur dhe do ta ndjekin rrugën e tij.

<http://www.jetaever8.de/>